

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

Departamenti për të drejta të njeriut dhe komunitete

**Përgjigjet e komunave ndaj zhvendosjes dhe kthimit
në Kosovë**

Nëntor, 2010

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
1. HYRJE.....	2
2. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE E POLITIKAVE	4
3. PËRGJIGJET E KOMUNAVE NDAJ ZHVENDOSJES DHE KTHIMIT	5
3.1 Strategjitë komunale për personat e zhvendosur dhe të kthyerit.....	5
3.2 Aktivitetet e asistencës komunale për personat e zhvendosur dhe të kthyerit..	11
4. SFIDAT ME TË CILAT BALLAFAQOHEN KOMUNAT NË PËRMBUSHJEN E NEVOJAVE TË PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE TË KTHYERVE.....	20
5. PËRFUNDIME	23
6. REKOMANDIMET	24
SHTOJCA I: Hartimi dhe miratimi i strategjive komunale për kthim (SKK).....	26

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport shqyrton progresin e komunave të Kosovës për të zhvilluar dhe zbatuar në mënyrë efikase strategji, politika dhe programe për personat e zhvendosur dhe të kthyerit në përputhje me kornizën normative dhe të politikave për kthim dhe mbrojtje dhe promovim të të drejtave të komunitetit. Raporti gjithashtu i identifikon dhe i analizon sfidat kryesore që i parandalojnë aktualisht institucionet komunale të sigurojnë asistencë dhe mbrojtje më efikase për personat e zhvendosur dhe për të kthyerit.¹ Raporti mbulon periudhën janar 2009 – qershor 2010. Gjetjet e prezantuara bazohen në aktivitetet e rregullta të monitorimit nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) në fushën e promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave të komunitetit dhe pjesëmarrjes së komuniteteve joshumicë në jetën publike.²

Raporti gjen që progresi i arritur në përmbushjen e obligimeve të komunave ka qenë i kufizuar dhe jo i njëjtë, ndonëse nga ato kërkohet të zhvillojnë dhe zbatojnë politika vjetore dhe strategji që ua mundësojnë atyre marrjen e përgjegjësisë për aktivitete të kthimit dhe riintegrit. Pak më shumë se gjysma e komunave në Kosovë kanë zhvilluar dhe miratuar strategji komunale të kthimit në vitin 2009. Në gjashtëmuorin e parë të 2010, vetëm nëntë komuna i kanë miratuar strategjitë për ta udhëhequr punën e tyre për kthim dhe riintegrim. Aty ku edhe janë miratuar strategjitë komunale për kthim, shpesh ndodh që të zbatohen vetëm pjesërisht. Disa komuna janë angazhuar në masë të konsiderueshme për ta përkrahur kthimin dhe zgjidhjet e qëndrueshme për personat e zhvendosur. Në komunat ku ka projekte për kthim dhe riintegrim, ato kryesisht udhëhiqen e financohen nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe organizatat ndërkombëtare, ndonëse komunat kontribuojnë për suksesin e projekteve duke i përkrahur dhe plotësuar aktivitetet në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Sfidat e vërejtura nga OSBE-ja në zhvillimin dhe zbatimin efikas të politikave, strategjive dhe programeve për personat e zhvendosur dhe për të kthyerit në nivel lokal janë të shumta. Ato përfshijnë përkushtimin e dobët politik ndaj kthimit nga zyrtarët relevantë, ndarjen e pamjaftueshme të resurseve financiare, mungesën e bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të nivelit lokal dhe qendror, si dhe kapacitete të kufizuara për bërje të politikave, planifikim të projekteve dhe zbatim të projekteve në nivel komunal. Pengesa të tjera siç janë qasja e kufizuar në pronë, mungesa e mundësive ekonomike, dhe vështirësitë për qasje në shërbime shëndetësore, asistencë sociale dhe mundësi të arsimimit janë gjithashtu relevante për ata persona që e konsiderojnë kthimin apo integrimin lokal dhe, si të tilla, ato duhet të adresohen në mënyrë efikase nga komunat në bashkëpunim me hisedarët relevantë në nivelin qendror dhe lokal.

Ky raport rithekson rolin kyç të komunave në krijimin e kushteve të favorshme për kthim dhe stabilitet të komunitetit në nivel lokal dhe jep rekomandime për komunat,

¹ Ky raport fokusohet në kthimet vullnetare dhe riintegrimin dhe nuk jep vlerësim për sfidat që rezultojnë nga numri në rritje i personave të riatdhesuar me forcë në Kosovë nga vende të treta (kryesisht vende të Evropës perëndimore). Megjithatë, sfidat me të cilat ballafaqohen komunat për t'iu përgjigjur nevojave të të kthyerve vullnetarë janë gjithashtu relevante për riintegrimin e personave të riatdhesuar me forcë.

² Për qëllim të këtij raporti, komunitetet joshumicë janë të gjitha ato komunitete që përbëjnë pakicë numerike në nivel komunal në Kosovë.

institucionet qendrore dhe komunitetin ndërkombëtar që të inkurajojnë kushte të tilla. Ekziston një nevojë për pjesëmarrje efikase, bashkërendim dhe ndarje të informacioneve ndërmjet hisedarëve relevantë në nivel qendror dhe lokal në të gjitha fazat e planifikimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe projekteve komunale për personat e zhvendosur dhe për të kthyerit; për forcimin e mekanizmave dhe kapaciteteve institucionale për t'i adresuar nevojat e personave të zhvendosur/të kthyerve; dhe për ndarjen e resurseve të nevojshme financiare për zbatimin e strategjive dhe programeve për të përkrahur kthimin ose zgjidhjet tjera të qëndrueshme për personat e zhvendosur/të kthyerit.

1. HYRJJE

Më shumë se dhjetë vjet pas konfliktit në Kosovë mungesa e një zgjidhjeje të qëndrueshme për një pjesë të konsiderueshme të afërsisht 220,000 refugjatëve dhe personave të zhvendosur³ nga Kosova vazhdon të jetë sfidë e madhe për të gjithë të përfshirët.⁴ Sipas Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), që nga viti 2000 vetëm përafërsisht 21,000 persona nga komunitetet joshumicë janë kthyer në rajon vullnetarisht nga vendet ku kanë qenë të zhvendosur brenda dhe jashtë.⁵ Derisa në vitin 2008 është parë një rënie e madhe në kthimet vullnetare, që nga ajo kohë procesi i kthimit ka parë përmirësim me një numër në rritje të personave të zhvendosur që janë kthyer në vitin 2009 dhe në muajt e parë të 2010.⁶ Megjithatë, pavarësisht nga deklaratat e fuqishme publike nga institucionet e Kosovës në përkrahje të kthimit dhe angazhimeve të serishme për t'i identifikuar dhe regjistruar personat e zhvendosur të interesuar për t'u kthyer në Kosovë, kthimi dhe riintegrimi i qëndrueshëm e komuniteteve joshumicë, në veçanti komunitetit serb, komunitetit rom, komunitetit ashkali dhe komunitetit egjiptian mbetet problematik. Në pengesat kryesore për kthim dhe riintegrim përfshihen: mungesa e punësimit dhe mundësive sociale-ekonomike, qasja e kufizuar në shërbime publike, çështjet e pazgjidhura të së drejtës banesore dhe pronësore dhe, deri në një masë të caktuar, brengat e sigurisë dhe liria e kufizuar e lëvizjes.

Institucionet e nivelit qendror dhe lokal të Kosovës janë gjithnjë e më shumë përgjegjëse për menaxhimin e procesit të kthimit dhe riintegrimin të refugjatëve dhe personave të zhvendosur dhe mbrojtjen e asistimin e tyre. Që nga viti 2006, shumë nga funksionet që më parë janë kryer nga organet ndërkombëtare, duke përfshirë bërjen e politikave, vendosjen e standardeve, bashkërendimin dhe zbatimin e

³ Kryesisht anëtarë të komunitetit serb dhe të komuniteteve tjera joshqiptare.

⁴ Sipas vlerësimeve të UNHCR, afërsisht 205,000 persona me origjinë nga Kosova janë të zhvendosur në Serbinë qendrore, ndërsa 11,000 mbeten të zhvendosur në Mal të Zi dhe 1,500 në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (UNHCR, Vlerësimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur në Evropën Juglindore që ende kërkojnë zgjidhje— siç ishte më 30 shtator 2010). Veç kësaj, numri i personave të zhvendosur brenda Kosovës vlerësohet të jetë 19,000 (Pasqyrë e përgjithshme statistikore, Zyra e Kryesuesit të Misionit të UNHCR Prishtinë/Priština— Përditësimi i fundit i bërë në tetor 2010).

⁵ Pasqyrë e përgjithshme statistikore Zyra e Kryesuesit të Misionit të UNHCR Prishtinë/Priština— Përditësimi i fundit i bërë në qershor 2010.

⁶ Në vitin 2009 u kthyen 1,153 anëtarë të komuniteteve joshumicë (përfshirë 439 serbë, 214 romë, 281 ashkali dhe egjiptianë, 43 boshnjakë, 90 goranë dhe 86 shqiptarë në nivel komunal ku ata janë pakicë) në krahasim me 679 në 2008 dhe 1,816 në 2007. Rreth 1,757 persona të zhvendosur janë kthyer vullnetarisht në shtëpitë e tyre gjatë periudhës janar-tetor 2010. (Pasqyrë e përgjithshme statistikore Zyra e Kryesuesit të Misionit të UNHCR Prishtinë/Priština— Përditësimi i fundit i bërë në tetor 2010).

projekteve të asistencës, janë bartur gradualisht në duart e institucioneve.⁷ Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare, i është përgjigjur kësaj sfide duke i forcuar politikat dhe strategjitë e saj ndaj personave të zhvendosur dhe të kthyerve, për shembull, duke i thjeshtuar hapat për kthim dhe duke u ofruar asistencë të kthyerve, forcuar mekanizmat e pjesëmarrjes për komunitetet joshumicë dhe duke u fokusuar më shumë në zhvillimin dhe stabilizimin e komuniteteve në mënyrë që të krijohen kushtet e favorshme për kthim dhe riintegrim të qëndrueshëm. Përderisa pushteti qendror është përgjegjës për ta siguruar kornizën e përgjithshme të politikave për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve dhe personave të zhvendosur si dhe burimet e nevojshme për zbatimin e saj, komunat duhet të sigurojnë zbatim të duhur dhe me kohë të këtyre politikave dhe kornizës operationale për kthim në terren.⁸ Komunat janë ofrueset kryesore të shërbimeve por ato kanë edhe përgjegjësinë për të përkrahur zhvillimin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në territorin e tyre, duke përfshirë këtu personat e zhvendosur dhe të kthyerit.⁹ Ato luajnë një rol thelbësor në formimin e politikave të qëndrueshme të kthimit dhe riintegrimit në nivel lokal dhe në zbatimin e aktiviteteve lokale të riintegrimit dhe zhvillimit për krijimin e kushteve për kthim dhe riintegrim të qëndrueshëm. Megjithatë, në shumë raste zbatimi i politikave dhe strategjive ekzistuese në nivel lokal është i dobët dhe komunat marrin mbi vete përgjegjësi të kufizuara në procesin e kthimit dhe riintegrimit.

Ky raport e shqyrton progresin e arritur të institucioneve komunale për të zhvilluar dhe zbatuar me efikasitet strategji, politika dhe programe për të personat e zhvendosur dhe të kthyerit, në përputhje me kornizën normative dhe të politikave për kthim dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Ai gjithashtu i identifikon dhe analizon sfidat kryesore që aktualisht i parandalojnë institucionet lokale për të siguruar mbrojtje dhe asistencë më efikase. Raporti përfshin një shqyrtim të shkurtër të kornizës ekzistuese ligjore dhe të politikave për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, që e thekson rolin dhe përgjegjësitë e komunave në procesin e kthimit, dhe rekomandimet kanë për qëllim tejkalimin e sfidave të identifikuar.

⁷ Që nga themelimi i tij më 1999, UNMIK ka ushtruar mandatin e tij në çështjet që lidhen me kthimin për të siguruar një kthim të sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë, siç përvijohet në rezolutën 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Si pjesë e bartjes së kompetencave nga UNMIK tek institucionet e Kosovës, përgjegjësitë dhe kompetencat administrative lidhur me kthimin janë bartur gradualisht tek institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës. Veç kësaj, brenda kontekstit të “procesit të lokalizimit” të udhëhequr nga UNCHR, nga viti 2007 qeveria dhe UNCHR kanë forcuar bashkëpunimin e tyre për t’i përmirësuar kapacitetet e rëndësishme për kthimin dhe zgjidhje të qëndrueshme, stabilizim dhe përkrahje për komunitetet në Kosovë, veçanërisht në nivelin komunal. Për më tepër, në angazhim për të përmirësuar bashkërendimin e aktiviteteve të kthimit ndërmjet autoriteteve qendrore dhe komunave, në nëntor 2008, UNHCR, në bashkëpunim me qeverinë, themeloi një Njësi koordinuese për mbështetje të kthimit në kuadër të zyrës së zëvendëskryeministrit.

⁸ Shih Kapitullin 2, Korniza e politikave për personat e zhvendosur dhe kthim.

⁹ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 mbi Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, 16 tetor 2007, që ndryshon rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, 11 gusht 2000, dhe Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, 15 qershor 2008.

2. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE E POLITIKAVE

Korniza ligjore në Kosovë e konfirmon të drejtën e të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpitë e tyre në mënyrë të sigurt dhe me dinjitet dhe për t'i marrë sërish pronat dhe pasuritë e tyre në pajtim me standardet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Institucionet e Kosovës duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për ta lehtësuar kthimin e sigurt të refugjatëve dhe personave të zhvendosur në Kosovë, dhe të bashkëpunojnë plotësisht me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe organizatat tjera ndërkombëtare dhe joqeveritare lidhur me kthimin e tyre.

Këto standarde e krijojnë bazën e kornizës së qeverisë për mbrojtjen e komuniteteve joshumicë dhe për politikat e saj për kthim dhe riintegrim apo zgjidhje tjera të qëndrueshme për personat e zhvendosur. Në nivelin qendror, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka mandat që të bashkërendojë punën me komunat, ministrinë dhe institucionet ndërkombëtare për të siguruar zbatim të duhur dhe me kohë të politikave dhe kornizës operationale për kthim. Grupet komunale të punës për kthim dhe zyrtarët komunalë për kthim dhe komunitete janë mekanizmat primar bashkërendues dhe pika të kontaktit për të gjitha projektet dhe aktivitetet që lidhen me kthimin në nivel lokal.

Në Kosovë janë miratuar disa strategji dhe dokumente të politikave që lidhen me kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur. Ato i caktojnë politikat për t'i mbrojtur dhe asistuar personat e zhvendosur dhe ofrojnë një kornizë institucionale për menaxhimin e kthimit vullnetar ose zgjidhjeve tjera të qëndrueshme. Doracaku i Rishikuar i vitit 2006 për Kthim të Qëndrueshëm (Doracaku)¹⁰ definojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe lokale në çdo fazë të procesit të kthimit dhe i përvijon procedurat dhe mekanizmat bashkërendues për t'i adresuar nevojat dhe promovuar të drejtat e personave të zhvendosur dhe të kthyerve.¹¹ Ai i përfshin objektivat kryesore të politikave të përditësuara të kthimit të miratuara nga qeveria e Kosovës më 24 maj 2006, si dhe Protokollin e 2006 për Kthim Vullnetarë dhe të Qëndrueshëm.¹² Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë¹³ siguron për kthimin e personave të zhvendosur që i përkasin këtyre komuniteteve në vendin e tyre të origjinës ose në ndonjë vend tjetër sipas zgjedhjes së lirë të tyre. Ajo gjithashtu parasheh masa specifike të asistencës që i synojnë këto tre komunitete. Përfundimisht, në tetor 2009, Ministria për Komunitete dhe Kthim miratoi Strategjinë për Komunitete dhe Kthim (2009-2013), që i vë një theks më

¹⁰ UNMIK/Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) Doracaku i Rishikuar për Kthimin e Qëndrueshëm, korrik 2006. Korniza e politikave e miratuar në 2006 bazohet në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke përfshirë dhe Parimet Udhëzuese të 1998 të Kombeve të Bashkuara për zhvendosjet e brendshme.

¹¹ Nga fundi i vitit 2008, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka iniciuar një rishikim të Doracakut me qëllimi të thjeshtësimit dhe kanalizimit të procedurave që kërkohen për t'i finalizuar dhe zbatuar programet dhe projektet e kthimit. Ndonëse mekanizmat e reja për ndihmë në kthim nuk janë miratuar ende, ato po zbatohen krahas Strategjisë së Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (2009-2013) që nga pranvera e vitit 2010. Ato përqendrohen më shumë në angazhimin e komunave dhe përgatitjen e mbështetjes së kthimit, si dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim për çështjet që lidhen me kthimin.

¹² Protokollin u nënshkrua më 6 qershor 2006 nga UNMIK, IPVQ-të dhe qeveria e Serbisë.

¹³ Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës (2009 – 2015), dhjetor 2008.

madh zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit të komuniteteve joshumicë për të inkurajuar dhe mundësuar tërthorazi kthimin e qëndrueshëm të të zhvendosurve.¹⁴

Brenda kësaj kornize, nga komunat kërkohet që të zhvillojnë dhe zbatojnë politika dhe strategji vjetore që ua mundëson atyre marrjen e përgjegjësisë së përgjithshme për kthim dhe riintegrim.¹⁵ Qëllimi i strategjive komunale për kthim është që t'ju sigurojnë zyrtarëve komunal një kornizë për të gjitha aktivitetet që lidhen me kthim, duke i përfshirë objektivat e gjëra komunale dhe aktivitetet specifike që synojnë krijimin e kushteve në terren për kthim dhe riintegrim. Strategjitë gjithashtu shërbejnë për lehtësimin e transparencës dhe konsistencës në punët që lidhen me kthim dhe për ta forcuar bashkërendimin ndërmjet të gjithë akterëve, ndërsa komunitetet e zhvendosura në veçanti inkurajohen që të angazhohen drejtpërdrejt në identifikimin e pengesave dhe strategjive për t'i tejkaluar ato.¹⁶ Komunat e kanë përgjegjësinë primare për zbatimin e nismave të kthimit dhe projekteve në nivel lokal, siç janë aktivitetet specifike që synojnë promovimin e dialogut dhe inkurajojnë tolerancën dhe përkrahjen për riintegrim social-ekonomik dhe zhvillim të komunitetit. Ato e kanë një obligim për të zhvilluar aktivitetet qasjeje dhe informimi për personat e zhvendosur për t'i informuar ata për situatën në vendin e tyre të origjinës dhe për asistencën që do ta kenë në dispozicion kur të kthehen.¹⁷

3. PËRGJIGJET E KOMUNAVE NDAJ ZHVENDOSJES DHE KTHIMIT

3.1 Strategjitë komunale për personat e zhvendosur dhe të kthyerit

Progresi i komunave në zhvillimin e strategjive komunale që kanë për qëllim asistimin e personave të zhvendosur dhe të kthyerve ka qenë i kufizuar dhe dallon në masë të madhe nga një komunë në tjetrën.¹⁸ Nëntëmbëdhjetë komuna¹⁹ miratuan strategji për kthim për vitin 2009, kurse 14 komuna²⁰ nuk e zhvilluan ndonjë strategji për ta udhëhequr punën e tyre në fushën e kthimit dhe riintegrimin. Deri në korrik të

¹⁴ Strategjia për Komunitete dhe Kthim (2009 – 2013) u miratua nga qeveria e Kosovës në shkurt 2010.

¹⁵ UNMIK/IPVQ Doracak i Rishikuar për Kthim të Qëndrueshëm, korrik 2006.

¹⁶ Në korrik 2004, UNMIK dhe IPVQ-të kanë nxjerrë një Dokument të përbashkët mbi politikën komunale të strategjisë për kthim, përfshirë këtu një shabllon të propozuar dhe rekomandime procedurale lidhur me zhvillimin dhe hartimin e strategjive komunale për kthim.

¹⁷ Nga fundi i vitit 2009, zyra e zëvendëskryeministrit, në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe Ministrinë për Administrim të Pushtetit Lokal, filloi me përpilimin e një rregulloreje qeveritare për zyrat komunale për komunitete dhe kthim. Rregullorja i udhëzon komunat në themelimin e strukturave administrative – Zyrat komunale për komunitete dhe kthim – për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave që i përkasin komuniteteve joshumicë, qasje të barabartë në shërbime publike për të gjitha komunitetet dhe për krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar. Rregullorja hyri në fuqi më 27 gusht 2010 (Rregullorja nr. 2/2010 për Zyrat komunale për komunitete dhe kthim).

¹⁸ Shih Aneksin I – Zhvillimi dhe miratimi i Strategjive Komunale për Kthim.

¹⁹ Ferizaji/Uroševac, Gjilani/Gnjilane, Kamenica/Kamenica, Novo Brdo/Novobërda, Vitia/Vitina, Skenderaji/Srbica dhe Vushtrria/Vučitrn, Istogu/Istok, Klina/Klina, Peja/Peć, Fushë Kosova/Kosovo Polje, Lipjani/Lipljan, Obiliqi/Obilić, Podujeva/Podujevo, Dragashi/Dragaš, Malishevë/Mališevo, Prizreni, Rahoveci/Orahovac, dhe Suhareka/Suva Reka.

²⁰ Hani i Elezit/Đeneral Janković, Kaçaniku/Kaçanik, Štrpce/Shtërpca, Mitrovica/Mitrovica, Leposavić/Leposaviqi, Zubin Potoku, Zvečan/Zveçani, Deçani/Dečane, Gjakova/Đakovica, Juniku, Gllgoc/Glogovac, Prishtina/Priština, Shtimja/Štimlje, dhe Mamuša/Mamusha/Mamuša.

vitit 2010, nëntë nga 33²¹ komuna të Kosovës e kanë finalizuar dhe miratuar strategjinë e tyre komunale për kthim për vitin 2010.²² Një numër i komunave janë të angazhuara në shqyrtimin zyrtar të strategjive të tyre për vitin 2009 dhe kanë filluar t'i zhvillojnë strategjitë komunale për kthim për vitin 2010.²³

Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, vetëm dy nga gjashtë komuna, përkatësisht Vushtrria/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica, e kanë miratuar një strategji apo plan të veprimit për kthim për vitin 2009 dhe 2010. Në rastin e Vushtrrisë/Vučitrn, strategjia për vitin 2010 parasheh vazhdimin e përkrahjes nga komuna për kthim në Dalak/Doljak dhe Shitaricë/Štitarica, përfshirë këtu aktivitetet siç është rindërtimi i rrugëve. Një projekt i ngjashëm është i planifikuar edhe për Priluzhje/Prelluzhë dhe Banjškë/Banjaska, të banuara me serbë. Strategjia për kthim gjithashtu parasheh përkrahjen për pjesën e qytetit të Vushtrrisë/Vučitrn ku jeton komuniteti ashkali. Komuna e Skenderajt/Srbica ende nuk e ka shqyrtuar zyrtarisht strategjinë komunale për kthim për vitin 2009 apo përpiluar strategjinë e re për vitin 2010, por e ka miratuar një plan veprimi komunal për kthim që përqendrohet në kthim në Runik/Rudnik dhe në projekte infrastrukturore në fshatrat Banja/Bajë dhe Suvo Grlo/Syriganë, të banuara me serbë.

Në Mitrovicë/Mitrovica, si dhe në komunat Leosavić/Leosaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zvečan në veri, ende nuk ka ndonjë strategji komunale për kthim. Komuna e Mitrovicës/Mitrovica kurrë nuk ka pasur politika apo strategji për kthim në formë të shkruar, por përqendrohet në aktivitetet për ta inkurajuar kthimin në Brdjani/Kroin e Vitakut, Mëhallën e romëve, Lagjen e boshnjakëve, Suhodoll/Suvi Do dhe Lagjen e doktorëve²⁴ përmes grupit punues komunal. Në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, Administrata e UNMIK-ut në veri të Mitrovica/Mitrovicës (UAM) kurrë nuk ka shkruar ndonjë strategji për kthim, por është e angazhuar në projekte që kanë të bëjnë me kthim, si p.sh. hartimi i një projekt-propozimi për infrastrukturë në Brdjani/Kroin e Vitakut për vitin 2010. Në tri komunat veriore, strategjitë e fundit komunale për kthim janë shkruar në vitin 2006 dhe 2007. Prej vitit 2008, komunikimi në mes institucioneve të Kosovës dhe komunave të Leosavić/Leosaviqit, Zubin Potokut dhe Zvečanit/Zvečanit është ndalur në tërësi. Megjithatë, para kësaj, tri komunat kanë qenë të angazhuara në proceset e kthimit dhe kanë zbatuar standarde të ngjashme me komunat tjera në Kosovë.

Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, pesë nga tetë komuna e kanë miratuar një strategji të kthimit në vitin 2009,²⁵ kurse deri në qershor të vitit 2010, vetëm Novo Brdo/Novobërda e ka shqyrtuar strategjinë e vet dhe e ka miratuar një të re që mbulon periudhën 2010-2013. Strategjia e Novo Brdo/Novobërdës për vitin 2010 përfshin vazhdimin e aktiviteteve të dialogut ndëretnik në vendet potenciale për kthim në

²¹ Komunitet e reja, Gračanica/Gračanica, Ranilug/Ranillugu, Klokot-Vrbovac/Klllokoti-Vërboci dhe Parteš/Parteshi, nuk janë përfshirë në këtë vlerësim për shkak se ende pritet të zhvillojnë politikën të pavarur të kthimit dhe riintegrimin të popullsisë së tyre të zhvendosur.

²² Dragashi/Dragaš, Fushë Kosova/Kosovo Polje, Lipjani/Lipljan, Novo Brdo/Novobërda, Podujeva/Podujevo, Shëmja/Štimlje, Prishtina/Priština, Suhareka/Suva Reka dhe Vushtrria/Vučitrn.

²³ Për shembull, Gjilani/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Vitia/Vitina, Istogu/Istok, Klina/Klina, Peja/Peć.

²⁴ Të gjitha në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, përveç Mëhallës së romëve.

²⁵ Gjilani/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Novo Brdo/Novobërda, Vitia/Vitina, dhe Kamenica/Kamenica

komunë, siç janë fshatrat Bostane/Bostan, Prekovce/Prekoc, Trniçe/vece/Tërniqec dhe Izvor, si dhe fazën e dytë të kthimit në fshatin Klobukar/Kllobukar. Për më tepër, ajo thekson nevojën për aktivitete të informimit, regjistrimit dhe monitorimit në përkrahje të kthimit në bashkëpunim me hisedarët ndërkombëtarë që veprojnë në terren.

Strategjia e Gjilanit/Gnjilane për kthim për vitin 2009 përqendrohet në përkrahjen e nismave të ndryshme për kthim për serbët dhe romët e zhvendosur, duke përfshirë qytetin e Gjilanit/Gnjilane dhe fshatrat e ndryshme në komunë.²⁶ Ajo gjithashtu parasheh përkrahjen për serbët e zhvendosur nga fshati Zhegër/Žegra për t'u integruar në vendin ku janë të zhvendosur, përfshirë këtu fshatrat Donja Budriqa/Budrikë e Poshtme, Parteš/Partesh, Pasjane/Pasjan dhe Gornje Kusce/Kufcë e Epërme.²⁷ Në Ferizaj/Uroševac, strategjia për kthim për vitin 2009 parashihte zhvillimin dhe implementimin e disa projekteve të organizuara për kthim për serbët e zhvendosur, duke përfshirë këtu fshatin Softaj/Softović, si dhe vazhdimin e përkrahjes për kthime individuale dhe spontane.²⁸ Në Viti/Vitina, strategjia për kthim për vitin 2009 nuk parashihte ndonjë nismë të rëndësishme për kthim përveç një numri të vizitave shko-dhe-shih²⁹ në fshatrat Drobesh/Drobeš, Gërmovë/Grmovo, Pozharan/Požaranje dhe në qytetin e Vitisë/Vitina.³⁰ Strategjia për kthim për vitin 2009 e Kamenicës/Kamenica përfshinte disa aktivitete në lidhje me kthim për serbët dhe romët, duke përfshirë këtu vlerësimin e kushteve për kthim dhe asistencën për personat e zhvendosur në fshatrat Berivojce/Berivojcë, Gragjenik/Građenik, Hogosht/Ogošte, Kosovica, Rahovicë/Oraovica dhe në qytetin e Kamenicës/Kamenica.³¹

²⁶ Aktivitetet e planifikuara përfshijnë përkrahjen për të kthyerit romë në lagjen Abdullah Presheva/Abdula Preševo; asistencën për kthim për personat e zhvendosur nga qyteti i Gjilanit/Gnjilane gjatë trazirave të marsit të vitit 2004; asistencën në natyrë për të gjithë personat e zhvendosur përmes zyrave komunale për komunitete; dhe, lehtësimin e kthimit në lagjen Štrbići/Shtربیći të fshatit Parallove/Paralovo.

²⁷ Zyrtari komunal për kthim i emëruar rishtas e ka përgatitur një version të parë të strategjisë komunale për kthim për vitin 2010. Ky version nuk ka ndryshime substanciale të objektivave dhe aktiviteteve në krahasim me versionin për vitin 2009. Shumë aktivitete vazhdojnë ende apo nuk janë zbatuar në vitin 2009. Fakti që grupi punues komunal për kthim nuk është mbledhur prej prillit të vitit 2009 e ka penguar procesin e miratimit të strategjisë.

²⁸ Zyrtari komunal për kthim e ka përgatitur versionin e parë të strategjisë për vitin 2010 dhe ua ka përcjellë atë hisedarëve përkatës, ku përfshihen zyrtarët e komunës, përfaqësuesit e personave të zhvendosur dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile. Në këtë version të strategjisë parashihet të vazhdohen aktivitetet e vitit 2009.

²⁹ Vizitat shko-dhe-shih ua ofrojnë personave të zhvendosur mundësinë që të marrin informata personalisht për kushtet në vendin e tyre të origjinës dhe të komunikojnë e angazhohen drejtpërdrejt me komunitetin pritës që të mund ta marrin një vendim të informuar për kthim apo zgjidhje tjera të qëndrueshme. Ata ftohen për t'i vizituar shtëpitë e tyre të mëparshme dhe për t'u takuar me fqinjët, pjesëtarët e komunitetit pritës dhe institucionet lokale si pjesë e vizitës së organizuar për t'i diskutuar çështjet me rëndësi të veçantë, siç janë asistencë për rindërtim të shtëpive, punësimi dhe mundësitë e gjenerimit të të ardhurave, siguria dhe liria e lëvizjes, mirëqenia sociale dhe pensionet, arsimi dhe shërbimet tjera publike. (Shih Doracakun e rishikuar për kthim të qëndrueshëm, UNMIK/IVPQ, korrik 2006).

³⁰ Strategjia për vitin 2010 është momentalisht në fazë të hartimit. Mes tjerash, ajo parasheh aktivitete të dialogut ndëretnik dhe kthimit në fshatrat Tërpezë/Trpeza, Pozharan/Požaranje dhe Sadovinë e Çerkezve/Čerkez Sadovina.

³¹ Komuna e Kamenicës/Kamenica ende nuk e ka shqyrtuar zyrtarisht strategjinë e vet për kthim për vitin 2009 apo vendosur për fushat e fokusit të komunës për vitin 2010. Sipas zyrtarit komunal për kthim, takimet e grupit punues komunal nuk mbahen momentalisht për shkak se nga niveli qendror nuk janë vënë në dispozicion kurrfarë fondesh për ta përkrahur projektin e planifikuar të kthimit në Rahovicë/Oraovica.

Në Štrpce/Shtërpçë, Kaçanik/Kaçanik dhe Han të Elezit/Đeneral Janković, nuk është zhvilluar kurrfarë strategjie për t'i asistuar personat e zhvendosur apo të kthyerit në vitin 2009 ose 2010. Strategjia e fundit për kthim që u shkrua dhe miratua në komunën e Štrpce/Shtërpçës ishte ajo e vitit 2008. Komuna tani përqendrohet në gjetjen e zgjidhjes së qëndrueshme për përafërsisht 700 serbë të zhvendosur nga Kosova dhe refugjatë serbë nga Kroacia që jetojnë në disa qendra kolektive në komunë.³² Në Kaçanik/Kaçanik, strategjia e fundit për kthim ishte shkruar në vitin 2006 dhe zyrtarët komunalë nuk kanë treguar vullnet për t'u angazhuar në aktivitete lidhur me kthimin. Hani i Elezit/Đeneral Janković ende nuk është angazhuar për hartimin e strategjisë për kthim prej kalimit nga njësi komunale pilot në komunë me të drejta të plota në gusht të vitit 2008.

Rajoni i Pejës/Peć

Në rajonin e Pejës/Peć, strategji komunale në vitin 2009 kishte në tri nga gjashtë komuna, përkatësisht në Pejë/Peć, Istog/Istok dhe Klinë/Klina. Të gjitha komunat në rajon ende nuk i kanë miratuar strategjitë e reja për kthim për vitin 2010. Në Pejë/Peć, fushat me prioritet sipas strategjisë për vitin 2009 ishin organizimi i vizitave shko-dhe-informohu³³, kryesisht për personat e zhvendosur momentalisht në Mal të Zi, përkrahja nga komuna për kthime individuale duke përfshirë projektet infrastrukturore,³⁴ vazhdimi i aktiviteteve të dialogut ndëretnik mes komuniteteve pritëse dhe të kthyerve, si dhe krijimi i një baze të të dhënave mbi personat e zhvendosur. Në vitin 2009, nismat u përqendruan kryesisht në zona rurale dhe fshatra.³⁵ Në komunën e Istogut/Istok, aktivitetet e planifikuara sipas strategjisë për vitin 2009 u përqendruan në informim dhe dialog, regjistrim të personave të zhvendosur dhe përkrahje për kthime individuale përmes grupit punues komunal dhe njësisive punuese.³⁶ Një projekt tjetër parashihte renovimin e gjashtë shkollave në komunë me përbërje të përzier etnike. Komuna e Klinës/Klina në vitin 2009 u përqendrua në përkrahjen për kthim individual dhe të organizuar, organizim të nismave për informim dhe dialog dhe përmirësim të situatës së sigurisë, qasjes në

³² Shih Raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë *Në kërkim të zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur në komunën e Štrpce/Shtërpçës*, mars 2010,1 të cilin mund ta gjeni në http://www.osce.org/documents/mik/2010/04/43384_en.pdf.

³³ Në vizitat shko-dhe-informohu, që bëhen në vendin e zhvendosjes, komuniteti i zhvendosur informohet për situatën në vendin e tyre të origjinës dhe vendet potenciale për kthim, duke përfshirë kushtet socio-ekonomike, sigurinë, lirinë e lëvizjes, si dhe për procedurat për kthim dhe mekanizmat përkrahës që i kanë në dispozicion. (Shih Doracakun e rishikuar për kthim të qëndrueshëm, UNMIK/IVPQ, korrik 2006).

³⁴ Për shembull, sistemin e furnizimit me ujë dhe asfaltimin e rrugës në vendbanimin 7 Shtatori dhe sistemin e ujitjes në Vitomiricë/Vitomirica.

³⁵ Vendet prioritare për kthim për serbët, romët dhe egjiptianët nga Kosova përfshinin lagjen 7 Shtatori dhe fshatrat Treboviq/Trebović, Nakëll/Naklo, Belo Polje/Bellopojë dhe Maje e Zezë/Crni Vrh. Komuna është angazhuar në shqyrtimin zyrtar të strategjisë së saj për vitin 2009, duke përfshirë konsultimet me të gjithë anëtarët e grupit punues komunal për kthim dhe organet tjera përkatëse të komunës. Strategjia për vitin 2010 parasheh vazhdimin e përkrahjes në fushat prioritare të identifikuara në vitin 2009, duke përfshirë një bazë të të dhënave për personat e zhvendosur që pritet të krijohet.

³⁶ Vendet prioritare për kthim përfshinin Belo Polje/Bellopojën, Dragolevcin e Epërm/Gornji Dragoljevac, Rudeshin/Rudeš në Serbobran/Srbobrane, Zallqin/Zaç, Kovragën/Kovrage, Grab/Shkozën dhe Sinajën/Sinaje. Strategjia për kthim për vitin 2009 është shqyrtuar zyrtarisht nga zyrtarët komunalë për kthim dhe komunitete, me përfshirje aktive të zyrtarëve të lartë, përfaqësuesve dhe shoqërive të personave të zhvendosur dhe hisedarëve tjerë kyçë. Strategjia për vitin 2010 parasheh vazhdimin dhe/ose finalizimin e projekteve të identifikuara në vitin 2009.

shërbime publike dhe bashkëpunimit mes gjykatave dhe Agjencisë Kosovare të Pronës në çështjet pronësore.³⁷

Komunat e Deçanit/Deçane dhe Gjakovës/Đakovica nuk e miratuan ndonjë strategji për kthim për vitin 2009. Në Deçan/Deçane, një bllokim nga përpjekjet e vazhdueshme të dështuara të grupit punues komunal për kthim për të caktuar përfaqësues të personave të zhvendosur në forum e ka parandaluar miratimin e strategjisë për kthim prej vitit 2008. Aktivitetet kryesore të planifikuara në vitin 2009 përfshinin zhvillimin e projekteve për kthim dhe infrastrukturë, organizimin e aktiviteteve për informim dhe dialog, ndërtimin e kapaciteteve për zyrtarët komunalë, krijimin e një baze të të dhënave të personave të zhvendosur dhe përmirësimin e qasjes së të kthyerve në shërbime publike.³⁸ Në komunën e Gjakovës nuk kishte as zyrtar të emëruar komunal për kthim, as grup të themeluar punues komunal për kthim në vitin 2009³⁹ dhe komuna ka treguar shumë pak interesim viteve të fundit për ta përkrahur kthimin. Strategjia e fundit komunale për kthim është shkruar në vitin 2008. Komuna e Junikut ende nuk e ka hartuar ndonjë strategji për kthim prej kalimit të saj nga njësia komunale pilot në komunë me të drejta të plota në gusht të vitit 2008.

Rajoni i Prizrenit

Në rajonin e Prizrenit, të gjitha komunat përveç Mamuşa/Mamushës/Mamuşa miratuan strategji të kthimit në vitin 2009. Që prej qershorit 2010, vetëm Suhareka/Suva Reka dhe Dragashi/Dragaş i kanë rishikuar strategjitë e tyre dhe e kanë miratuar një dokument të ri të politikave për vitin 2010.⁴⁰ Në Suharekë/Suva Reka, strategjia për vitin 2010 nuk parashikon ndryshime të mëdha në krahasim me strategjinë e mëparshme, duke u fokusuar kryesisht tek çështjet e sigurisë, lirisë së lëvizjes, mjedisin e përgjithshëm për kthim, qasjen në shërbime publike, infrastrukturë, si dhe shfrytëzimin e kapaciteteve njerëzore. Një pjesë për investime kapitale në lidhje me projektet infrastrukturore në lagje e fshatra të përziera është integruar gjithashtu brenda planit zhvillimor komunal, si ndërtimi i shtëpive për të kthyerit, shkollës fillore në Mohlan/Movljane, si dhe disa ndërtime rrugësh në dobi të fshatrave (më parë) shumetnike. Në Dragash/Dragaş, strategjia e vitit 2010 nuk dallon shumë nga pararendësja e saj, duke u përqendruar kryesisht në përfshirjen më të madhe të strukturave komunale dhe akterëve komunalë në çështjet e kthimit, sidomos në fushën e infrastrukturës, shëndetësisë, arsimit dhe sigurisë, si dhe tek përfshirja aktive e personave të zhvendosur në procesin e përgjithshëm.⁴¹

Në Prizren, strategjia e vitit 2009 kishte përcaktuar fusha tejet përgjithësuese të prioriteteve, si promovimi i procesit të kthimit, siguria dhe liria e lëvizjes, organizimi i vizitave shko-dhe-shih dhe shko-dhe-informohu, si dhe aktivitetet e dialogut

³⁷ Komuna planifikon që në vitin 2010 t'i realizojë projektet dhe vazhdojë përkrahjen e saj në fushat e identifikuara në vitin 2009.

³⁸ Zyrtari komunal për kthim e ka përgatitur një version të parë të strategjisë komunale për kthim për vitin 2010 për t'u aprovuar nga grupi punues komunal për kthim.

³⁹ Qeveria e re komunale e zgjedhur në nëntor të vitit 2009 duket të jetë më përkrahëse për kthim. Në maj të vitit 2010, posti i zyrtarit komunal për kthim u plotësua më në fund. Megjithatë, komuna ende nuk e ka themeluar grupin punues komunal për kthim.

⁴⁰ Në Malishevë/Mališevo, strategjia e vitit 2010 (që është gati identike me strategjinë e vitit 2008 dhe atë të vitit 2009), është hartuar, por ajo duhet miratuar nga grupi punues komunal për kthimin.

⁴¹ Pesë projekte të ndërtimit të rrugëve, si dhe projektet në lidhje me rezervuarët e ujit dhe një stadiumi sportiv, janë zbatuar në vitin 2009 nga Qeveria e Kosovës dhe komunat, derisa një numër projektesh më të vogla është zbatuar nga organizatat partnere ndërkombëtare.

ndëretnik, mbështetja dhe ndihma për të kthyerit dhe ri-integrimi i tyre.⁴² Në komunën e Rahovecit/Orahovac, fusha kryesore e fokusimit më 2009 përfshin fillimin e një projekti të kthimit në Zoqishtë/Zocište, identifikimin e lokacioneve të reja të mundshme të kthimit, si dhe procesin e integritit gradual të të kthyerve jo-shumicë.⁴³ Në Malishevë/Mališevo, veprimet në lidhje me kthimin sipas strategjisë 20090 ishin përqendruar tek iniciimi i dialogut ndëretnik mes personave të zhvendosur dhe komunitetit pritës shumicë, organizimi i vizitave shko-dhe-shih në Kijevë/Kijevo, si dhe identifikimi i donatorëve për ndihmë të mundshme.⁴⁴ Komuna e Mamuşa/Mamushës/Mamuša ende nuk ka hartuar strategji të kthimit qysh prej kalimit të saj nga një njësi komunale pilot në komunë me të drejta të plota në gusht të vitit 2008.

Rajoni i Prishtinës/Priština

Në rajonin e Prishtinës/Priština, katër nga shtatë komuna e kanë miratuar strategjinë e kthimit më 2009.⁴⁵ Pesë komuna, gjegjësisht Fushë Kosova/Kosovo Polje, Lipjani/Lipljan, Podujeva/Podujevo, Prishtina/Priština, dhe Shtimja/Štimlje kanë miratuar strategji të re për vitin 2010. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, strategjia komunale e vitit 2010 përfshin edhe vazhdimin e mbështetjes për projektet e kthimit në vazhdim e sipër, të zbatuara nga donatorë të ndryshëm, si dhe lehtësimin e kthimit individual dhe grupor të serbëve të zhvendosur, për shembull në fshatin Miradi e Eperme/Gornje Dobrevu. Strategjia komunale e kthimit e Lipjanit/Lipljan për vitin 2010 përqendrohet në mbështetjen e kthimeve individuale dhe grupe në qytetin e Lipjanit/Lipljan dhe fshatrat e ndryshme në komunë, si Hallaqi i Vogël/Mali Alaš, Magurë/Magura, Vershevc/Vrsevce, dhe Vrelle/Vrelo, si dhe përmirësimet e infrastrukturës në vendet e kthimit në përgjithësi. Në Podujevë/Podujevo, strategjia e vitit 2010 parasheh mbështetjen në riintegrimin e romëve dhe ashkalive, organizimin e aktiviteteve të dialogut ndëretnik dhe identifikimin e nevojave të komuniteteve, sidomos në fushat e arsimit dhe infrastrukturës. Komuna e Prishtinës/Priština ka identifikuar si fusha prioritare përfshirjen më të madhe të mekanizmave pjesëmarrës të nivelit lokal, përmirësimin e bashkërendimit me shoqatat e personave të zhvendosur, organizimin e aktiviteteve të dialogut dhe vetëdijesimit publik për të promovuar sigurinë dhe tolerancën mes komuniteteve⁴⁶, si dhe mbështetjen për kthimin individual. Strategjia e Shtimes/Štimlje parasheh ofrimin e mbështetjes komunale për kthimin individual, duke përfshirë zonat urbane, organizimin e aktiviteteve të dialogut, përforcimin e organizatave të shoqërisë civile dhe përmirësimin e kushteve për kthim, duke përfshirë fushat e zhvillimit ekonomik, punësimit dhe banimit.

⁴² Nuk është bërë rishikimi thelbësor i strategjisë së kthimit të vitit 2009, derisa nuk ka as draft të strategjisë për vitin 2010.

⁴³ Në komunën e Rahovecit/Orahovac, e cila ende nuk ka organizuar grupin punues komunal për kthimin më 2010, procesi i hartimit të strategjisë komunale të kthimit për 2010 nuk është iniciuar ende.

⁴⁴ Megjithatë, asnjë nga aktivitetet e sipërpërmendura nuk janë kryer deri tani. Komuna ka finalizuar draftin e parë të strategjisë për vitin 2010. Drafti është miratuar nga Kuvendi Komunal, por nuk është diskutuar e as pranuar nga grupi punues komunal për kthimin. Draft-Strategjia, gati kopje e strategjive të vitit 2008 dhe 2009, përqendrohet në çështje të ngjashme dhe përmban një numër propozim-projektësh, si rindërtimi i rrjeteve të ujit dhe energjisë elektrike në fshatin e Kijevës/Kijevo për financim të mundshëm nga donatorët.

⁴⁵ Gjegjësisht Fushë Kosova/Kosovo Polje, Lipjani/Lipljan, Obiliqi/Obilić, dhe Podujeva/Podujevo.

⁴⁶ Për shembull në Nëntë Jugoviq/Devet Jugovic, Lëbanë/Lebane, Bërmicë e Epërme/Gornja Brnjica, si dhe në lokacione të caktuara të qytetit të Prishtinës/Priština.

Komuna e Obiliqit/Obilić ende nuk e ka miratuar strategjinë për vitin 2010 për shkak të mungesës së mbështetjes nga udhëheqësia komunale. Strategjia e kthimit për vitin 2009 përqendrohej në aktivitetet e kthimit në mëhallën Sharagan/Saragan (në qytetin e Obiliqit/Obilić), Plementin/Plementina, Milloshevë/Miloševo, qytetin e Obiliqit/Obilić si dhe Babin Most/Babimoc. Fushat kryesore të angazhimit përfshinin regjistrimin civil, qasjen në arsim, shëndetësi dhe ndihmë sociale për të kthyerit, bashkëpunimin me Agjencinë Kosovare të Pronës në rastet e uzurpimit të paligjshëm të pronave, përfshirjen e departamenteve tjera komunale në procesin e kthimit, si dhe identifikimin e fondeve në dispozicion për projekte të gjenerimit të të ardhurave. Përfundimisht, komuna e Gillogocit/Glogovac nuk ka shkruar kurrë strategji komunale të kthimit, duke pohuar si shkak numrin e vogël të komuniteteve joshumicë që jetonin në komunë para konfliktit të vitit 1999 si dhe numrit të vogël të personave të zhvendosur.

Me shumë pak përjashtime, komunat nuk kanë ndarë burime specifike buxhetore për zbatimin e aktiviteteve të propozuara në fushat e identifikuara si prioritare në strategjitë e tyre komunale të kthimit. Në vend të këtyre, institucionet lokale zakonisht mbështeten në fonde që sigurohen nga niveli qendror apo organizatat ndërkombëtare për zbatimin e aktiviteteve në lidhje me kthimin. Në shumë raste, kjo ka penguar zbatimin efektiv të projekteve dhe aktiviteteve të propozuara të projektuara për të ndihmuar personat e zhvendosur dhe të kthyer. Në përgjithësi, komunat nuk kanë ndërmarrë hapa për t'i integruar strategjitë komunale të kthimit brenda planifikimit të tyre zhvillimor komunal, apo për t'i marrë parasysh implikimet buxhetore të strategjive. Në përgjithësi, strategjitë komunale të kthimit ende nuk janë të qarta sa duhet, shpesh janë dobët të hartuara apo nuk janë të azhurnuara në krahasim me nevojat dhe brengat e identifikuara.

3.2 Aktivitetet e asistencës komunale për personat e zhvendosur dhe të kthyerit

Strategjitë komunale të kthimit, kur miratohen, zbatohen vetëm pjesërisht. Në shumë raste, ka një zbrazëti të konsiderueshme mes aktiviteteve të planifikuara dhe atyre të realizuara dhe buxhetet e propozuara shpesh i kalojnë resurset në dispozicion, si në nivelin lokal ashtu dhe në atë qendror. Megjithatë, disa komuna kanë bërë përpjekje në mbështetje të projekteve të kthimit të qëndrueshëm. Një numër aktivitete, kryesisht të financuara nga niveli qendror dhe donatorët ndërkombëtarë, kanë qenë të suksesshme, sidomos në ofrimin e ndihmës për personat e zhvendosur dhe për të kthyerit me projekte të rindërtimit dhe gjenerimit të të ardhurave dhe asistencës themelore (p.sh. artikuj ushqimor dhe jo-ushqimor), si dhe për të siguruar që shërbimet publike të jenë në dispozicion për të lehtësuar riintegrimin e tyre. Përveç këtyre, zyrtarët në disa komuna kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në vizita tek personat e zhvendosur për t'i informuar ata për gjendjen në vendin e tyre të origjinës dhe asistencën që është në dispozicion për kthim.⁴⁷

Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica

Komuna e Mitrovicës/Mitrovica përgjithësisht ka qenë mbështetëse e kthimit në Mëhallën e Romëve dhe së voni në rilokimin e personave të zhvendosur që jetonin në

⁴⁷ Vizitat, duke përfshirë vizitat shko-dhe-shih dhe shko-dhe-informohu, kryesisht organizohen nga UNHCR dhe Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) në bashkëpunim me Zyrën e Qeverisë Amerikane për Popullsi, Refugjatë dhe Migrim.

kampet e kontaminuara me plumb në pjesën veriore të komunës.⁴⁸ Megjithatë, një pjesë e madhe e kësaj mbështetjeje ka ardhur si rezultat i presionit nga bashkësia ndërkombëtare. Në vitin e kaluar, e vazhdueshme ka qenë Iniciativa e Bashkimit Evropian e mbështetjes për romët, ashkalitë dhe egjiptianët (EU-MRSI) si dhe Programi për Rivendosjen/Riintegrimin ekonomik, social, tranzicional, avokimin e komunitetit RAE (RESTART), financuar nga Komisioni Evropian dhe USAID-i dhe zbatuar nga Mercy Corps, të cilat synojnë mbylljen e kampeve të kontaminuara me plumb, Osterode dhe Česmin Lug në Mitrovica/Mitrovicën veriore, si dhe t'i vendosin shumicën e banorëve në bllokun e shtëpive në Mëhallën e Romëve.⁴⁹ Në maj të vitit 2009, komuna miratoi një dokument që ofronte hollësi mbi rendin e shtëpive që do të ndërtohej brenda programeve të vazhdueshme të rivendosjes. Megjithatë, Kuvendi i Komunës ende nuk ka lëshuar ndonjë vendim formal për ndarjen e tokës komunale për një periudhë 99-vjeçare për përfituesit e programeve EU-MRSI dhe RESTART. Zëvendëskryetari i komunës për komunitete dhe zyrtari komunal për kthim e organizojnë dhe udhëheqin Komitetin lokal drejtues, të themeluar për bashkërendimin e aktiviteteve të palëve të ndryshme të përfshira në zbatimin e projektit. Mes sfidave kryesore që duhen trajtuar është edhe përfshirja efektive e komuniteteve në të gjitha fazat e zbatimit të projektit dhe vendimmarrjes për të, si dhe sigurimi i qasjes adekuate në shërbime publike, duke përfshirë kujdesin e duhur mjekësor për banorët e kampit që vuajnë nga helmimi me plumb, si dhe ndaj arsimit, punësimit dhe mundësive të gjenerimit të të ardhurave.

Përveç këtyre, institucionet komunale kanë marrë pjesë në një numër vizitash shko-dhe-shih për serbët dhe romët në qytetin e Mitrovicës/Mitrovica dhe fshatrat Staritërg/Stari Trg dhe Tunel i Parë/Prvi Tunel. Përfundimisht, në pranverën e vitit 2009, perspektiva e kthimit të shqiptarëve në Brdjani/Krua të Vitakut në veri të Mitrovica/Mitrovicës ka drejtuar vëmendjen tek projekti i lënë anash i kthimit në Svinjarë/Svinjare në jug.⁵⁰ Në qershor të vitit 2009, komuna e Mitrovicës/Mitrovica pati filluar financimin e përkohshëm të linjës së përditshme të autobusit mes Mali Zvečan/Zveçanit të Vogël në komunën Zvečan/Zveçanit dhe Svinjarës/Svinjare në jug të Mitrovicës/Mitrovica për t'ua bërë të mundur të zhvendosurve t'i vizitojnë pronat e tyre, të cilat janë rindërtuar në vitin 2006, por që nga ajo kohë kanë mbetur gjerësisht të pabanuara.

Në komunat e Vushtrisë/Vučitrn dhe Skenderajt/Srbica, vetëm disa iniciativa në lidhje me personat e zhvendosur janë zbatuar në vitin 2009 dhe 2010. Për shembull, një projekt i kthimit i financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim ishte zbatuar në fshatrat Dalak/Doljak dhe Shtitaricë/Stitarica në partneritet me komunën e

⁴⁸ Gjithsej 124 familje të zhvendosura kudo në Serbi, Mal të Zi dhe kampet e kontaminuara Osterode, Česmin Lug dhe Leposavić/Leposaviq ishin kthyer në Mëhallën e Romëve nën kornizën e programeve të organizuara të iniciuara nga UNMIK-u dhe Komuna e Mitrovicës/Mitrovica dhe të implementuara nga DRC dhe NCA mes viteve 2007 dhe 2009.

⁴⁹ Qëllimi kryesor i projektit RESTART është të sigurojë kushte dhe jetesë më të sigurt dhe më të mirë për rreth 50 familje të zhvendosura romë dhe ashkali nga kampet e kontaminuara Osterode dhe Česmin Lug. Përveç banimit, projekti synon të mbështesë qasjen ndaj shërbimeve sociale dhe shëndetësore, arsimit, punësimit dhe jetesës së sigurt. Iniciativa EU-MRSI synon të lehtësojë rivendosjen e 90 familjeve tjera romë dhe ashkali nga kampet Osterode dhe Česmin Lug në Mëhallën e Romëve, si dhe të mundësojë riintegrimin e tyre ekonomikisht produktiv, të sigurt dhe të shëndoshë.

⁵⁰ Kur filloi rindërtimi i Brdjani/Kroit të Vitakut, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës insistonin që çdo kthim në veri duhet të shoqërohet me një kthim në jug.

Vushtrrisë/Vučitrn. Projekti përfshinte rindërtimin e 15 shtëpive, 13 shtëpi për familjet serbe dhe dy shtëpi për raste të familjeve shqiptare të cenushme, si dhe rehabilitimin e sistemit të kanalizimit dhe instalimin e një pompe të ujit nga komuna. Më 2009, komuna gjithashtu mundësoi qasjen në shërbime komunale për një numër të kthyerve individualë serbë në fshatra të ndryshme në komunë, derisa më 2009 dhe 2010, ka marrë pjesë në vizita shko-dhe-shih për serbë dhe ashkali të zhvendosur në vende të ndryshme brenda komunës, duke përfshirë Pantinën/Pantina dhe Samadrexhën/Samodreža.⁵¹ Në Skenderaj/Srbica, zbatimi i një projekt-propozimi për kthim në fshatin e Runikut/Rudnik është ende në pritje të gjetjes së resurseve financiare. Më 2009, zyrtarët komunalë kanë marrë pjesë në vizita shko-dhe-informohu për personat e zhvendosur të Runikut/Rudnik për t'i informuar ata për progresin e projektit.

Asistenca që ofrohet nga institucionet komunale dhe organizatat ndërkombëtare është e vogël dhe jo e rregullt për t'i mbështetur personat e zhvendosur në komunat veriore të Zvečan/Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposavić/Leposaviqit. Në Zubin Potok, UNHCR po kërkon financim për mbështetje të serbëve nga Kroacia dhe Kosova që janë të zhvendosur. Një projekt banimi parashikon ndërtimin e njëzet shtëpive në fshatrat Zupce/Zupç dhe Jagnjenica/Jagnjenicë. Një projekt tjetër synon të mbështesë zhvillimin e aktiviteteve të biznesit lokal, duke ndërtuar një sistem ftohës për produktet bujqësore. Në Zvečan/Zveçan dhe Leposavić/Leposaviq,⁵² nuk është ofruar ndonjë ndihmë e konsiderueshme nga institucionet komunale apo organizatat ndërkombëtare për personat e zhvendosur.⁵³

Rajoni i Gjilanit/Gnjilane

Komuna e Gjilanit/Gnjilane, Ferizajt/Uroševac dhe Novo Brdo/Novobërdës në përgjithësi e kanë mbështetur kthimin e personave të zhvendosur serbë, romë dhe ashkali në fshatra të ndryshme dhe lagje urbane. Për shembull, në kuadër të projektit për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë I (KRKI),⁵⁴ janë ndërtuar 15 shtëpi për familjet serbe në fshatrat Gornje Kusce/Kufcë e Epërme, Pasjane/Pasjan dhe Parteš/Partesh, në bashkëpunim të ngushtë me komunën e Gjilanit/Gnjilane.⁵⁵ Për më tepër, në vitin

⁵¹ Për shembull, shtatë shtëpi për të kthyerit serbë ishin rindërtuar në fshatrat e Grace/Gracës dhe Priluzje/Prelluzhës brenda kornizës së projektit SPARK, të menaxhuar nga UNDP-ja dhe të financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, në bashkëpunim me komunën.

⁵² Qysh prej qershorit 1999, komuna e Leposavić/Leposaviqit ka filluar të pranojë persona të zhvendosur nga e gjithë Kosova dhe tani është nikoqire e rreth 2.500 personave. Shumica e serbëve të zhvendosur jetojnë në vendbanime private, me të afërm, apo në qendra kolektive në qytetin e Leposavić/Leposaviqit dhe vendbanimet e Lešak/Leshakut dhe Sočanica/Soçanicës.

⁵³ Disa kërkesa për asistencë për të kthyerit e komunitetit shqiptar u pranuan dhe miratuan nga Ministria për Komunitete dhe Kthim përmes UNHCR-së në bashkëpunim me zyrtarët komunalë për kthim të këtyre komunave.

⁵⁴ Projekti Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë I (KRKI) është nismë e përbashkët e financuar nga Komisioni Evropian dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim në partneritet me UNDP-në që ka për qëllim kthimin e qëndrueshëm e refugjatëve dhe peronave të zhvendosur përmes përfshirjes së shtuar të akterëve qeveritarë dhe joqeveritarë si në nivelin qendror ashtu dhe në ate lokal. Projekti është duke u zbatuar në katër komuna: Istog/Istok, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Pejë/Peć, dhe Gjilan/Gnjilane gjatë një periudhe prej 21 muaj.

⁵⁵ Faza e dytë në vazhdim e projektit të KRKI i ka cak familjet serbe të Kosovës, që janë me origjinë nga Zhegra/Žegra, të cilët kanë vendosur të integrohen në vendet e tyre të zhvendosjes. Kuvendi komunal ka miratuar ndarjen e tokës komunale në fshatin Donja Budriga/Budrigë e Poshtme për ndërtimin e shtëpive të gjashtë familjeve serbe, ndërsa dy kërkesa tjera për tokën komunale në fshatrat Donja Budriga/Budrigë e Poshtme dhe Pasjane/Pasjan ende nuk janë miratuar. Tre shtëpi

2009 komuna u ka ndarë tokë në lagjen Gllamë/Glama gjashtë familjeve rome⁵⁶ të zhvendosura, ndërsa UNHCR-i dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim ka mbështetur financiarisht ndërtimin e shtëpive. Gjashtë familjeve tjera iu miratua asistencë e kthimit në vitin 2010 nga komuna, UNHCR dhe Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe kjo u financua bashkërisht nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe UNCHR..Zyrtarët komunalë kanë marrë pjesë në një sërë vizitash shko-dhe-shih e shko-dhe-informohu për serbët dhe romët e zhvendosur të Kosovës, duke përfshirë qytetin e Gjilanit/Gnjilane dhe disa fshatra të komunës,⁵⁷ si dhe lokacione të ndryshme në këtë rajon. Në Ferizaj/Uroševac, në kuadër të projektit SPARK të menaxhuar nga UNDP-ja,⁵⁸ janë ndërtuar nëntë shtëpi për familjet serbe në fshatin Softaj/Softović deri në prill 2010. Megjithatë, ndonëse anëtarët e këtyre familjeve i kanë marrë në posedim këto shtëpi, kthimi i tyre i vërtetë ende nuk ka ndodhur. Me kërkesë të komunitetit pritës shqiptar, komuna ishte pajtuar më herët që t'i rregullojë rrugët që çojnë në vendin e kthimit dhe procesi i rindërtimit është kryer në muajin mars. Projekti për kthim dhe riintegrim në Kosovë II (KRKII)⁵⁹ synon të ofrojë ndihmë për (ri-)ndërtim dhe mbështetje për riintegrim një numri të familjeve të zhvendosura serbe dhe rome të Kosovës.⁶⁰ Procesi i ndarjes së tokës për projektin e banimit është duke ecur ngadalë. Institucionet komunale kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në vizitat shko-dhe-informohu dhe shko-dhe-shih për personat e zhvendosur, duke përfshirë qytetin e Ferizajt/Uroševac dhe fshatrat e ndryshme në komunë, si dhe lokacionet e ndryshme në rajon.⁶¹ Në komunën e Novo Brdo/Novobërdës, aktivitetet lidhur me kthimin janë përqendruar kryesisht në zbatimin e projektit për kthim të organizuar në fshatin Klobukar/Kllobukar, të financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe nga komuna. Në korrik të vitit 2009, 22 familje serbe janë kthyer në shtëpitë e tyre të posa rindërtuara në fshat. Institucionet komunale, veçanërisht zyrtarët e departamentit të sapo formuar për komunitete dhe kthim janë angazhuar në

për familjet e zhvendosura nga Zhegra/Žegra do të rindërtohen në tokën tanimë që i përket përfituesve në fshatrat Gornje Kusce/Kufcë e Epërme, Parteš/Partesh, dhe Pasjane/Pasjan.

⁵⁶ Këto familje kanë jetuar në pronat shoqërore në lagjen Qener qeshme/Čener česma në qytetin e Gjilanit/Gnjilane dhe janë zhvendosur në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

⁵⁷ Për shembull, në fshatrat Përlepnice/Prilepnica dhe Zhegër/Žegra dhe në lagjen Abdullah Presheva/Abdula Preševo në qytetin e Gjilanit/Gnjilane.

⁵⁸ Partneritetet e Qëndrueshme për Asistimin e Kthimit të Pakicave në Kosovë (SPARK) është zhvilluar në vitin 2005 për të ofruar mekanizëm ombrellë të integruar për sigurimin e spektrit të plotë të asistencës shumë-sektoriale si për kthimin individual ashtu edhe për atë grupor. Projekti, i cili përfundoi në fillim të vitit 2010, u realizua nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e Kosovës, më saktësisht me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, komunat dhe OJQ-të lokale.

⁵⁹ Projekti për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë II (KRKII) është nismë e financuar bashkërisht nga Komisioni Evropian dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, dhe është realizuar nga Këshilli Danez për Refugjatë. Projekti ka për synim mbështetjen e qëndrueshme të refugjatëve dhe personave të zhvendosur gjatë periudhës 24 mujore të realizimit të këtij projekti. Është realizuar në katër komuna: Klinë/Klina, Ferizaj/Uroševac, Obiliq/Obilić, dhe Rahovec/Orahovac.

⁶⁰ Katër familje të komunitetit ashkali aktualisht të zhvendosura në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe nëntë familje serbe të zhvendosura në Leskovac/Leskovc, Niš/Nish, Kragujevac/Kragujevc dhe Kraljevo/Kraleve janë përfshirë në listën e përfituesve të projektit. Shtatë familje serbe kanë vendosur të mos kthehen për arsye të ndryshme dhe Këshilli Danez për Refugjatë, si agjenci implementuese, aktualisht është në proces të përzgjedhjes së përfituesve tjerë nga radhët e serbëve të zhvendosur .

⁶¹ Për shembull, në Talinoc të Muhaxhirëve/Muhadžer Talinovac, Bablak/Babljak, Softaj/Softović, Nakodim/Nekodin, Balaj/Stojković, Sazli/Sazlija, Neredime/Nerodimlje, Gërllicë/Grlica dhe Doganaj/Doganović.

mënyrë aktive për të ndihmuar të kthyerit me procedurat e regjistrimit civil si dhe çështjet tjera të rëndësishme lidhur me projektin për kthim.⁶²

Në komunën e Vitisë/Vitina dhe Kamenicës/Kamenica, janë realizuar vetëm disa nisma lidhur me kthimin gjatë vitit 2009 ose 2010. Pas një muaji dialog ndërmjet komunitetit pritës shqiptar dhe UNHCR-it, kuvendi komunal i Vitisë/Vitina ka miratuar ndarjen e tokës komunale për ndërtimin e shtëpive nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe UNHCR-i për dy familje rome të kthyer në fshatin Radivojc/Radivojce.⁶³ Zyrtarët komunal kanë marrë pjesë në një numër vizitash shko-dhe-shih, duke pasur si synim serbët aktualisht të zhvendosur në lokacione të ndryshme në Serbinë jugore si dhe romët e zhvendosur në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.⁶⁴ Në Kamenicë/Kamenica, përkundër shprehjes së interesimit nga disa familje rome të zhvendosura për t'u kthyer në vendin e tyre të origjinës apo rivendosjes në fshatra tjera, komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë hap për lehtësimin e kthimit dhe riintegrimin të tyre. Në vitin 2009, institucionet komunale kanë marrë pjesë në vizitat shko-dhe-shih për dhjetë persona serbë të zhvendosur në fshatin Rahovicë/Oraovica dhe një vizitë vijuese është realizuar në fund të muajit korrik 2010. Grupi punues komunal për kthim, tani është duke shqyrtuar dokumentin koncept që ka për qëllim mbështetjen e kthimit të tyre.

Në Štrpce/Shtërpçë, Kaçanik/Kaçanik dhe Han të Elezit/Đeneral Janković, gjatë viteve 2009 dhe 2010 nuk janë zhvilluar aktivitete të rëndësishme lidhur me kthimin. Në Štrpce/Shtërpçë, aktivitetet janë përqendruar në gjetjen e zgjidhjeve për personat e zhvendosur, që jetojnë në qendrat kolektive në Brezovica/Brezovicë. Në qershor 2010, komuna ka ndarë tokën komunale dhe ka shpallur tenderin për tri objekte banesore për strehimin e personave të zhvendosur dhe personave me probleme sociale, të cilët për momentin jetojnë në qendrat kolektive. Kjo nismë financohet nga qeveria e Kosovës. Përkundër shprehjes së interesimit të herëpashershëm të personave të zhvendosur romë për t'u kthyer në Kaçanik/Kaçanik, komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë hap ose masë konkrete për mbështetjen e kthimit të tyre. Në mënyrë të ngjashme, kthimi i serbëve dhe romëve nuk renditet lartë në agjendën e komunës së Hanit të Elezit/Đeneral Janković.

Rajoni i Pejës/Peć

Komuna e Pejës/Peć, Istogut/Istok dhe Klinës/Klina në përgjithësi kanë mbështetur kthimin e personave të zhvendosur, që i përkasin komunitetit serb, rom dhe ashkali. Për shembull, në kuadër të kornizës së projektit KRKI, një numër i familjeve serbe të zhvendosura janë ndihmuar rreth kthimit në disa lokacione të komunës së Pejës/Peć.⁶⁵ Veç kësaj, komuna ka ndihmuar kthimin e 27 egjiptianëve në qytetin e Pejës/Peć, Ljesane/Leshanit, Vitomirica/Vitomiricës dhe Vragovac/Vragocit, si dhe pesë familjeve rome në qytetin e Pejës/Peć. Zyrtarët komunalë, duke përfshirë

⁶² Komuna ka kërkuar mbështetje shtesë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim që të merren me problemet lidhur me mungesën e ujit të pijshëm dhe mungesën e rrymës në disa prona, vonesat në fillimin e aktiviteteve për gjenerimin e të ardhurave dhe ofrimin e sigurisë së zotërimit të pronës për përfituesit.

⁶³ Procesi u vonua sepse përfaqësuesit e fshatit më parë i kishin dërguar letër kryesuesit të komisionit për politikë e financa, duke kundërshtuar kthimin dhe pohuar, që këto familje kanë qenë të përfshira në grabitjen e shtëpive të braktisura gjatë konfliktit 1999.

⁶⁴ Për shembull, në fshatrat e Tërpezës/Trpeza, Pozharanit/Požaranje dhe Radivojcit/Radivojce.

⁶⁵ Për shembull, në Vitomiricë/Vitomirica, vendbanimi joformal i Llazoviqit/Lazović, Belo Polje/Bellopojës, qytetit të Pejës/Peć, si dhe të fshatrave Nakëll/Naklo dhe Maja e Zezë/Crni Vrh.

zëvendëskryetarin për komunitete, kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në një sërë vizitash shko-dhe-shih për familjet serbe, rome dhe ashkali në qytetin e Pejës/Peć dhe në disa fshatra në këtë komunë,⁶⁶ si dhe në disa vizita shko-dhe- informohu në Podgoricë dhe Beranë, në Mal të Zi. Komuna e Istogut/Istok, në kuadër të projektit KRKII, ka mbështetur kthimin e personave të zhvendosur serbë në fshatrat Gurakoc/Đurakovac, Osojane/Osojan, Cërkolez/Črkolez dhe të tjera. Për më tepër, komuna bashkëpunoi drejtpërdrejtë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe një organizatë lokale joqeveritare për ta përkrahur kthimin e 20 familjeve serbe në fshatin Sinajë/Sinaje në vitin 2009. Veç kësaj, në kuadër të të njëjtit projekt 16 familje egjiptiane nga Rudeshi/Rudeš dhe dy familje rome janë rilokuar në fshatin Serbobran/Srbobran në vitin 2009. Toka për mundësinë e rilokimit është ndarë nga komuna.⁶⁷ Në vitin 2010, komuna, më tutje ka bashkëpunuar drejtpërdrejtë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe akterët tjerë në asistimin e kthimit spontan të familjeve serbe në lokacione të ndryshme në komunë, duke përfshirë këtu në Zallq/Žac, Dragoljevac/Dragolevc dhe Muževine/ Muzhevinë.⁶⁸ Në fund, janë realizuar 13 vizita shko-dhe-shih e shko-dhe-informohu nga Këshilli Danez për Refugjatë dhe UNHCR-i në bashkëpunim me zyrtarët komunalë, duke përfshirë vendet e kthimit në Serbobran/Srbobran dhe disa vende tjera serbe si dhe vendet e zhvendosjes në Mal të Zi.⁶⁹ Në Klinë/Klina, kohëve të fundit janë kthyer 20 familje serbe në kuadër të kornizës së projektit KRKII të realizuar në partneritet me komunën, ndërsa disa familjeve tjera u është aprovuar asistencë e kthimit.⁷⁰ Për më tepër, komuna ka mbështetur kthimin e personave të zhvendosur serbë në fshatrat Pogragjë/Pograde, Rudice/Rudicë, Pjetric/Potrc si dhe në Berkovë/Berkovo. Një numër i familjeve të komunitetit ashkali, të cilat janë kthyer në mënyrë spontane në komunë, kanë pranuar pako ndihmash humanitare nga UNHCR-i, por këto familje duhet të mbështeten ende me masa tjera për riintegrim nga ana e komunës. Zyrtarët komunalë kanë marrë pjesë në 13 vizita shko-dhe-shih e shko-dhe-informohu, duke përfshirë qytetin e Klinës/Klina dhe disa fshatra të komunës si dhe vende të ndryshme të zhvendosjes në tërë rajonin.⁷¹

Në Deçan/Dečane dhe Gjakovë/Đakovica, janë realizuar vetëm disa aktivitete për të mbështetur kthimin e personave të zhvendosur. Zyrtarët komunal në Deçan/Dečane

⁶⁶ Për shembull, fshatrat e Zahaqit/Zahać, Vitomiricës/Vitomirica, Ozdrim/Ozrimit, Bllagajës/Blagaje, Berzhnikut/Brežanik, Bllagajës/Blagaje, Turjakës/Turjak dhe Treboviqit/Trebovic si dhe vendbanimi 7 Shtatori/7 Septembar, vendbanimi Kristali dhe qyteti i Pejës/Peć.

⁶⁷ Nevojitet ndihmë e mëtutjeshme për t'i zgjidhur problemet lidhur me vërshimin e vazhdueshëm të lokacionit të kthimit dhe furnizimin me ujë dhe rrymë të amvisërive, si dhe për të siguruar zotërimin e pronës dhe qasjen në dokumente, edukim dhe mundësi për gjenerimin e të ardhurave për të kthyerit.

⁶⁸ Në fshatin Zallq/Žac, diku rreth 20 - 30 kryefamiljarë serbë janë kthyer në mënyrë spontane në mars 2010 dhe tani jetojnë në tendat e siguruar nga UNHCR-i. Në fund të muajit maj 2010, sipas zyrtarit komunal për kthim, në komunë janë parashtruar mbi 120 kërkesa për të kërkuar ndihmë për t'u kthyer në Zallq/Žac dhe lokacione tjera. Ndërtimi i 35 shtëpive të reja për të kthyerit serb dhe për komunitetin pritës në Zallq/Žac dhe Dragoljevac/Dragolevc, financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim ka filluar në korrik të vitit 2010.

⁶⁹ Personat e zhvendosur i kanë vizituar fshatrat Muzhevinë/Muževina, Grab/Shkoza, Dubravë/Dubrava, Belicë/Belica, Banjë/Banja, Polan/Polane dhe Serbobran/Srbobran.

⁷⁰ Vendet e kthimit janë fshatrat Dolc/Dolac, Grebnik/Grebnik dhe qyteti i Klinës/Klina.

⁷¹ Vizitat shko-dhe-shih janë realizuar në qytetin e Klinës/Klina dhe në fshatrat Dollc/Dolac, Drsnik/Dresnik, Pogragjë/Pograde, Drenoc/Drenovac, Budisalc/Budisavci dhe Dollc/Dolac. Vizitat shko-dhe-informohu përfshijnë Kraljevo/Krlevën, Kragujevac/Kragujevcin dhe Čačak/Čačakun.

kanë marrë pjesë në vizitat shko-dhe-shih për të kthyerit potencialë serbë dhe në vitin 2009, zyrtari komunal për kthim ka udhëhequr vizitën shko-dhe-informohu në Mal të Zi për t'i diskutuar, me këtë rast, çështjet lidhur me kthimin për personat e zhvendosur serbë dhe malazezë.⁷² Nuk është ndërmarrë asnjë aktivitet i rëndësishëm për lehtësimin e kthimit të familjeve të zhvendosura romë, ashkali dhe egjiptiane. Në Gjakovë/Đakovica, nuk është realizuar asnjë projekt i rëndësishëm për mbështetjen e të kthyerve. Gjatë vitit 2009-2010, u zbatua projekti SPARK i menaxhuar nga UNDP-ja për të mbështetur kthimin e gjashtë familjeve egjiptiane në lagjen Brekoc/Brekovac dhe fshatin Dujakë/Dujak. Për më tepër, në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe UNHCR-në, komuna ua aprovoi edhe tetë familjeve romë, ashkali dhe egjiptiane asistencën për kthim. Zyrtarët komunalë kanë marrë pjesë në tre vizita shko-dhe-shih për komunitetet romë dhe ashkali, aktualisht të zhvendosur në Mal të Zi. Komuna gjithashtu është përfaqësuar në vizitat shko-dhe-shih para personave të zhvendosur egjiptianë dhe romë në Mal të Zi. Vizita shko-dhe-shih për 15 persona të zhvendosur serbë është shtyrë vazhdimisht në pesë muajt e fundit për shkak të mungesës së pohuar të marrëveshjes ndërmjet akterëve relevantë për listën e pjesëmarrësve.

Rajoni i Prizrenit

Komuna e Prizrenit është angazhuar në mënyrë aktive në ofrimin e ndihmës gjatë viteve 2009 dhe 2010. Krahas nismave kryesore është edhe projekti për kthim në fshatin Sërbicë e Poshtme/Donja Srbica, për të cilën komuna ka mbajtur disa takime me akterët ndërkombëtarë dhe komunitetin pritës dhe ka organizuar vizita shko-dhe-informohu dhe shko-dhe-shih të serbëve të zhvendosur në fshat.⁷³ Për më tepër, përgatitjet për rindërtimin e dhjetë shtëpive të serbëve në qendër të qytetit të Prizrenit, të financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe donatorëve ndërkombëtarë janë në proces e sipër. Zyrtarët komunalë kanë marrë pjesë në disa vizita shko-dhe-shih.⁷⁴ Komuna e Prizrenit gjithashtu është duke treguar angazhim të ri në qasjen tek disa të kthyer të mundshëm të zhvendosur brenda Kosovës. Për shembull, në tetor 2009, zyrtari komunal për kthim ka vizituar për herë të parë që nga konflikti 1999, për afërsisht 25 (prej 200 të vlerësuar) serbë të zhvendosur në komunën e Štrpce/Shtërpçës.

Në përgjithësi, Suhareka/Suva Reka dhe Rahoveci/Orahovac e kanë mbështetur të kthyerit dhe bartin pronësinë e procesit. Për shembull, në Suharekë/Suva Reka, vizita e parë e mundshme shko-dhe-informohu që nga konflikti 1999, është kryer me sukses në qershor të vitit 2010. Zyrtari komunal për kthim i Suharekës/Suva Reka, me mbështetjen logjistike nga UNHCR-i, ka marrë pjesë në një vizitë dy ditore në Beograd, ku ai dhe përfaqësuesi i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim u takuan me serbët e zhvendosur të fshatrave Mushutishtë/Mušutište, Reçan/Recane, Leshan/Lešane dhe Mohlan/Movljane për të inkurajuar kthimin e tyre dhe informuar për gjendjen aktuale në komunë. Veç kësaj, zyrtarët komunal kanë marrë pjesë në një numër vizitash shko-dhe-shih.⁷⁵ Të gjitha vizitat karakterizohen me angazhim aktiv të

⁷² Si rezultat, në vitin 2010, në komunë janë parashtruar 13 kërkesa të reja për ndihmë rreth kthimit nga ana e serbëve që janë aktualisht të zhvendosur në Mal të Zi.

⁷³ Komuna ka ndarë 90,000 euro për rregullimin e sistemit të furnizimit me ujë të fshatit, ndërsa Ministria për Komunitet dhe Kthim ka investuar për afërsisht 340,000 euro për ndërtimin e 13 shtëpive të personave të zhvendosur serb dhe katër shtëpive për përfituesit nga komuniteti pritës.

⁷⁴ Për shembull, në qytetin e Prizrenit, një në Vrbiçane/Vërbicanë dhe një në Lubizhdë/Ljubizda.

⁷⁵ Për shembull, në fshatrat e Mushutishtit/Mušutište, Mohlanit/Movljane dhe Reçanit/Reçane.

kryetarit ose zëvendëskryetarit të komunës. Në Rahovec/Orahovac, KRKII është projekti kryesor për ndihmë. Në mars të vitit 2010, zyrtari komunal për kthim, përfaqësuesit e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Këshilli Danez për Refugjatë dhe UNHCR-i kanë marrë pjesë në një vizitë vlerësimi, ku janë takuar me 50 përfitues të mundshëm serb. Veç kësaj, gjatë viteve 2009 dhe 2010, është organizuar një vizitë shko-dhe-shih në qytetin e Rahovecit/Orahovac për 12 serb të zhvendosur dhe një vizitë shko-dhe-shih në fshatin Zoçiste/Zoqishtë për 30 serb të zhvendosur, me përfshirjen aktive të zyrtarëve komunal, duke përfshirë këtu kryetarin e komunës dhe zyrtarët tjerë të lartë. Vizita në fshatin Zoçiste/Zoqishtë është paraprirë me vizitën shko-dhe-informohu, në Beograd nga zyrtarët komunalë së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe UNHCR-it. Kryetari i komunës dhe zyrtarët tjerë të lartë komunalë kanë premtuar në disa raste se do të bëhet ndarja e tokës, por kjo nuk është arritur ende.

Komuna e Dragashit/Dragaš vazhdon të inkurajojë kthimin e personave të zhvendosur në komunë dhe rregullisht u siguron të kthyerve potencial këshilla dhe udhëzime për ndihmën në dispozicion pasi që të kthehen. Megjithatë komuna, në mungesë të buxhetit për zyrtarin komunal për kthim, nuk është në gjendje të luaj një rol proaktiv në lidhje me aktivitetet e kthimit.⁷⁶ Në vitin 2009, zyrtari komunal për kthim, së bashku me zyrtarin komunal për komunitete dhe disa zyrtarë të lartë komunal, morën pjesë në një vizitë shko dhe informo te pjesëtarët e komunitetit Goranë të zhvendosur në Beograd, të organizuar nga UNHCR. Përfundimisht, në Malishevë/Mališevo dhe Mamuša/Mamushës/Mamuša së fundi nuk janë ndërmarrë projekte ndihme për personat e zhvendosur. Aktiviteti i fundit në Malishevë/Mališevo ishte në vitet 2002 dhe 2003, kur KFOR-i Gjerman dhe Policia e Kosovës organizoi vizitat e personave të zhvendosur, serbë kosovar, në këtë komunë. Deri më tani, Komuna e Mamuša/Mamushës/Mamuša nuk është përfshirë në ndonjë aktivitetet të ndërlidhur me kthimin, pra që kur është shndërruar nga një pilot njësi komunale në komunë me funksionalitet të plotë në muajin gusht 2008.

Rajoni i Prishtinës/Priština

Në Prishtinë/Priština, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić, dhe Shtime/Štimlje disa nisma me qëllim të mbështetjes të kthimit të personave të zhvendosur serbë, rom dhe ashkali janë zbatuar gjatë vitit 2009 dhe 2010. Në Prishtinë/Priština, nisma kryesore e kthimit të familjeve serbe, të zhvendosura në Kosovë dhe në rajon, është aktualisht duke u zbatuar në fshatin Llapjesellë/Laplje Selo nga Ministria për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me komunën. Në vitin 2010, 33 banesa u janë dorëzuar përfituesve të projektit, që përfshinte 19 familje të zhvendosura jashtë Kosovës dhe 14 tjera në vendbanime të ndryshme në Kosovë.⁷⁷ Ndërtimi i banesave për 88 familje tjera të zhvendosura është në proces e sipër. Për më shumë, disa familje rome dhe ashkali në lagjet Divanjoll, Besi/Besinja dhe Vranjevc/Vranievac kanë përfituar nga ndihma për rindërtimin e shtëpive, që ishte siguruar nga Ministria

⁷⁶ Në mungesë të kontributeve financiare, komuna nuk ishte në gjendje të marrë pronësinë e plotë të procesit të kthimit. Përkundër shqetësimeve të zyrtarit komunal për kthim, nuk është ndarë një buxhet i veçantë për aktivitetet e ndërlidhura me kthimin në vitet e fundit. Në bashkëpunim me komunën dhe UNHCR-në, Ministria për Komunitete dhe Kthim ua ka aprovuar asistencën për kthim disa familjeve.

⁷⁷ Që nga ajo kohë, përgjegjësitë për projektin, që parasheh ndihmën socio-ekonomike dhe për strehim për rreth 60 familje (24 familje të zhvendosura jashtë Kosovës, 30 brenda Kosovës dhe 6 raste sociale) i janë kaluar komunës të porsa themeluar të Graçanicës/Gracanica.

për Komunitete dhe Kthim dhe UNHCR në bashkëpunim me komunën. Zyrtarët komunal morën pjesë në aktivitete të ndryshme të informimit, të organizuara nga UNHCR dhe Këshilli Danez për Refugjatë gjatë vitit 2009 dhe 2010.⁷⁸ Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, institucionet komunale mbështetën aktivitetet brenda kornizës së projektit RRKI. 23 familje të zhvendosura, prej së cilave 14 ashkali, dy rome, gjastë serbe dhe një malazeze, përfituan nga ndihma për rindërtimin e shtëpive dhe masat për nxitjen e të ardhurave.⁷⁹ Zyrtari komunal për kthim dhe ai për komunitete morën pjesë në disa vizita shko dhe informo në disa vende të ndryshme në rajon.

Në komunën e Obiliqit/Obilić, zyrtarët komunal ishin të përfshirë në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të projektit RRKII dhe në mundësimin e takimeve para kthimi, si dhe në aktivitete të informimit për të identifikuar personat e zhvendosur të që kanë shprehur interesimin për tu kthyer në komunë.⁸⁰ Përveç kësaj, komuna ofroi mbështetje për kthimin e disa familjeve rome dhe egjiptiane fshatrat Plemetin/Plemetina dhe Obiliq i Vjetër/Stari Obilić, të cilat përfituan nga ndihma për rindërtimin e shtëpive sipas projektit SPARK të menaxhuar nga UNDP. Zyrtarët komunal për kthim dhe komunitete dhe nënkryetari për komunitete morën pjesë në disa vizita shko dhe shih, që përfshinin personat e zhvendosur serbë, romë dhe ashkali nga Kosova, dhe në një varg vizitash shko-dhe-informo në disa vende të rajonit.⁸¹ Në Shtime/Štimlje, gjatë viteve 2009 dhe 2010 tetë familje ashkali, prej 21 anëtarësh, janë kthyer vullnetarisht në vendin e tyre të origjinës në qytetin e Shtimes/Štimlje. Të gjitha familjet kanë përfituar nga ndihma për nxitjen e të ardhurave dhe strehim sipas projektit SPARK të menaxhuar nga UNDP, dhe po ashtu ndihmë humanitare (ushqim dhe artikuj joushqimor) nga UNHCR. Institucionet komunale, përfshirë nënkryetarin, zyrtarin për kthim dhe zyrtarin për komunitete, morën pjesë në dy vizita shko dhe shih të personave të zhvendosur, serbë kosovar, në fshatin Muzeqinë/Muzičane dhe të familjeve ashkali në qytetin e Shtimes/Štimlje, të organizuara nga Këshilli Danez për Refugjatë.

Në komunat e Lipjanit/Lipljan, Podujevës/Podujevo dhe Glogocit/Glogovac janë zbatuar pak, për të mos thënë fare, aktivitete të ndërlidhura me kthimin gjatë viteve 2009 dhe 2010. Në Lipjan/Lipljan, komuna ka përkrahur kthimin e disa familjeve të zhvendosura rome dhe ashkali gjatë viteve 2009 dhe 2010. Në Podujevë/Podujevo dhe Glogoc/Glogovac, nuk është zbatuar asnjë projekt i veçantë për të ndihmuar personat e zhvendosur në gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme.

⁷⁸ Për shembull, zyrtari komunal për kthim mori pjesë në dy vizita shko dhe informo në qendrën kolektive “Konik I dhe II” dhe në një vizitë në Beran, Mal të Zi, dhe gjithashtu në një vizitë shko dhe informo në Novi Sad dhe Zrenjanin të Serbisë, ku disa familje kosovare rome, ashkali dhe egjiptiane janë të zhvendosur.

⁷⁹ Vendet e kthimit në komunë përfshijnë romët, ashkallitë dhe egjiptianët kosovar që banojnë në lagjet 02, 07, 028, 029 të qytetit dhe në fshatin Nakaradë/Nakarade.

⁸⁰ Në përgjithësi, sipas projektit 22 familje, midis tyre 12 serbe, gjastë rome dhe katër ashkali, do të përfitojnë nga rindërtimi i shtëpive dhe ndihma socio-ekonomike.

⁸¹ Për shembull, në Serbi, në Krushevc, Nish, Kraljevë, Beograd, Novi Sad, Suboticë, Pozharevc, Vrnjačka Banjë, Matarushka Banjë, Obrenovc, Kragujevc dhe Svilajnac, si dhe në Podgoricë dhe Berane të Malit të Zi dhe në Shkup të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

4. SFIDAT ME TË CILAT BALLAFAQOHEN KOMUNAT NË PËRMBUSHJEN E NEVOJAVE TË PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE TË KTHYERVE

Edhe pse disa komuna kanë ndërmarrë përpjekje të mëdha për t'i mbështetur personat e zhvendosur dhe të kthyerit, kryesisht brenda kornizës së projekteve të financuara nga niveli qendror dhe donatorët e ndryshëm ndërkombëtar, kthimi dhe riintegrimi i personave të zhvendosur paraqet një sfidë të madhe për komunat e Kosovës. Sfidat në nivel lokal janë të shumta në lidhje me përpilimin dhe zbatimin efikas të politikave, strategjive dhe projekteve për personat e zhvendosur dhe të kthyerit. Ato përfshijnë mungesën e vullnetit politik të institucioneve lokale për të përkrahur kthimin, mungesën e burimeve financiare në nivel komunal dhe kapacitete të kufizuara për hartim të politikave, planifikim dhe zbatim të projekteve nga institucionet komunale. Për më shumë, bashkërendimi i pamjaftueshëm ndërmjet hisedarëve përkatës në nivel komunal, si dhe ndërmjet institucioneve qendrore dhe komunale dhe po ashtu funksionimi i dobët i mekanizmave institucional dhe të bashkërendimit në disa komuna, paraqesin sfida që pengojnë institucionet lokale në ofrimin e ndihmës efikase për personat e zhvendosur dhe të kthyerit.

Mungesa e vullnetit politik apo gatishmërisë për kthim

Një ndër pengesat kryesore për miratimin dhe zbatimin efektiv të politikave, strategjive dhe projekteve, me qëllim të ofrimit të ndihmës për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, nga disa komuna për mbështetjen e kthimit është vullneti apo gatishmëria e kufizuar politik. Përpilimi i strategjive komunale për kthim duhet të udhëhiqet nga zyrtarët e lartë, përfshirë Kryetarin e komunës, Nënkryetarin dhe Drejtorët e Drejtorive, që marrin rolin udhëheqës dhe përgjegjës në drejtpërdrejt për procesin. Megjithatë, në shumicën e rasteve, ky proces udhëhiqet nga zyrtarët komunal për komunitete dhe kthim me përfshirje apo mbështetje të vogël nga udhëheqja komunale. Në të kaluarën kjo ka çuar në vonesa për miratimin e strategjive të kthimit si edhe në dështimin e integritit të strategjive të kthimit në planet zhvillimore komunale, që marrin parasysh implikimet buxhetore të strategjive.

Zbatimi me kohë i aktiviteteve apo projekteve të planifikuara, në rastet ku janë miratuar strategjitë komunale për kthim, shpesh pengohet nga mungesa e gatishmërisë nga udhëheqja komunale për t'u angazhuar në mënyrë aktive në aktivitetet e ndërlydhura me kthimin, dhe për të siguruar mbështetjen e domosdoshme administrative, financiare dhe logjistike për zyrtarët komunal për kthim dhe komunitete për t'i ndihmuar personat e zhvendosur dhe të kthyerit. Veç kësaj, mungesa e vullnetit politik shpesh shfaqet si element thelbësor në çështjen e ndarjes së tokës për iniciativat e planifikuara të kthimit. Përderisa në shumicën e komunave zyrtarët komunal për komunitete dhe kthim rregullisht angazhohen në aktivitete të informimit, përfshirë vizitat shko dhe shih, dhe shko dhe informo, mungon pjesëmarrja apo përfshirja aktive e zyrtarëve të lartë gjatë këtyre vizitave. Gjithashtu, pjesëmarrja e zyrtarëve të lartë në organet e kthimit dhe grupet punuese është e ulët dhe në disa raste kjo parandalon këto organe në zbatimin e duhur të funksioneve të tyre, siç janë lehtësimi i bashkërendimit ndërmjet hisedarëve të përfshirë në procesin e kthimit. Shpesh herë përgjegjësia për të ndihmuar personat e zhvendosur dhe të kthyerit u lihet krejtësisht zyrtarëve komunal për kthim dhe/apo zyrtarëve komunale për komunitete. Edhe pse këta individë mund të jenë të përkushtuar për të punuar për një kthim të qëndrueshëm, mungesa e interesit dhe e mbështetjes nga udhëheqja komunale shpesh herë ka një ndikim të dëmshëm.

Mungesa e burimeve financiare

Zbatimi efikas i politikave aktuale qeveritare dhe i projekteve për kthim dhe riintegrim shpesh pengohet nga mungesa e burimeve financiare në nivel komunal për të ndihmuar në mënyrë të duhur personat e zhvendosur dhe të kthyerit. Strategjitë komunale për kthim, nëse miratohen, zakonisht nuk mbështeten me fonde të mjaftueshme për të zbatuar këto strategji. Shumë shpesh nuk përcaktohen qartë kërkesat e veçanta për burime të ndërlidhura me një aktivitet apo projekt të propozuar. Nuk përcaktohet qartë nëse komunat planifikojnë të përdorin buxhetet e tyre apo nëse do të kërkojnë burime tjera të financimit për ndërmarrjen e aktiviteteve apo projekteve të propozuara. Kjo nënkupton që në shumë raste, strategjitë komunale të kthimit janë një listë e qëllimeve të mira pa një buxhet të ndarë për zbatimin e tyre. Edhe pse komunat kanë obligim të sigurojnë një financim të duhur për t'i ndihmuar personat e zhvendosur dhe të kthyerit në lidhje me riintegrimin e tyre, ato në realitet mbështeten kryesisht në fondet e gatshme nga niveli qendror për zbatimin e aktiviteteve të propozuara komunale apo projekteve me qëllim të ofrimit të ndihmës për personat e zhvendosur apo të kthyerit.

Në shumicën e komunave, nuk ekziston një linjë e veçantë buxhetore për përkrahjen e kthimit dhe të aktiviteteve të riintegrimin apo sigurimin e funksionimit efikas të organeve komunale me mandat mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komuniteteve, përfshirë edhe personat e zhvendosur dhe të kthyerit. Përveç disa përjashtimeve, zyrtarëve komunal për komunitete dhe kthim nuk iu sigurohen burime të mjaftueshme financiare për të përmbushur përgjegjësitë e tyre ditore në përkrahjen e personave të zhvendosur dhe të kthyerve. Për shembull, shumë nga këta zyrtarë nuk kanë pajisje minimale operative siç janë kompjuterët, telefonat apo automjetet. Pa automjete, zyrtarët komunal për komunitete dhe kthimin nuk mund të kryejnë aktivitetet e informimit, që janë të domosdoshme. Gjithashtu, shpeshherë ka pamjaftueshmëri të fondeve për adresimin e kërkesave për ndihmë apo për të ndihmuar aktivitetet në vendin e kthimit. Kjo mungesë e përkrahjes së duhur buxhetore nënkupton se zyrtarët komunal, që janë përgjegjës për përmbushjen e nevojave të personave të zhvendosur apo të kthyerve, shpesh nuk janë të gjendje të përmbushin ato në mënyrë efektive.

Mungesa e kapaciteteve për hartim të politikave, planifikim dhe zbatimin të projekteve

Sfidë për përpilimin dhe zbatimin efektiv të politikave dhe projekteve, që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, vazhdon të paraqesë pamjaftueshmëri e kapaciteteve administrative dhe teknike e institucioneve komunale. Zyrtarët komunal për komunitete dhe kthim në Kosovë kanë marrë pjesë në trajnime të shumta, që janë organizuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe zyrtarët janë shumë mirë të njoftuar për rolin dhe përgjegjësitë e tyre. Megjithatë kapacitetet administrative dhe teknike të zyrtarëve përkatës, përfshirë Kryetarët, Nënkyetarët dhe Drejtorët e Drejtorive, për tu marrë me çështjet e zhvendosjeve dhe kthimit mbesin të ulëta. Në shumë raste, zyrtarët nuk kanë njohuri për nevojat e veçanta të personave të zhvendosur dhe të kthyerve, si edhe nuk kanë kapacitete për të përpiluar dhe zbatuar një strategji gjithëpërfshirëse të kthimit, politikat dhe projektet nëpërmjet një procesi pjesëmarrës që përfshin aktorët përkatës nga fusha e kthimit. Si pasojë, cilësia e strategjive dhe projekteve të ndihmës shpesh herë është e ulët. Megjithatë, në ato raste ku komunat kanë pranuar përkrahje të konsiderueshme për t'i asistuar ato në zbatimin e projekteve

të kthimit dhe riintegrimin – për shembull, përmes dy projekteve të RRK – kapacitetet po përmirësohen gradualisht. Ndonëse aktualisht këto projekte u ofrojnë asistencë vetëm tetë komunave të Kosovës, në të ardhmen pritet fillimi i projekteve të ngjashme.

Mungesa e bashkërendimit në nivel komunal dhe ndërmjet niveleve qendrore dhe lokale

Një ndër sfidat kryesore për një planifikim dhe zbatim efektiv të strategjive, politikave dhe projekteve për kthim dhe riintegrim, që është cituar vazhdimisht nga zyrtarët komunal, është mungesa e bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet hisedarëve të përfshirë në procesin e kthimit. Në shumë raste, strategjitë komunale për kthim përpilohen kryesisht nga zyrtarët komunal për komunitete dhe kthim se sa nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse me pjesëmarrjen e zyrtarëve komunal nga drejtoritë e ndryshme, mekanizmat pjesëmarrës të nivelit lokal, përfaqësuesit nga shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare si dhe personat e zhvendosur dhe shoqatat e tyre. Në komunat ku ekzistojnë grupet punuese funksionale për kthim, shpesh herë mungon bashkëpunimi ndërmjet këtij trupi dhe të tjerëve që janë përgjegjës për çështjet e komuniteteve joshumicë.⁸² Zyrtarët e lartë komunal, komuniteti pritës dhe përfaqësuesit e personave të zhvendosur shpesh herë nuk marrin pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve punuese dhe të njëjseve punuese, që janë themeluar për përpilimin e strategjive komunale dhe për bashkërendimin e aktiviteteve të projektit. Përgjigja e duhur ndaj nevojave të personave të zhvendosur dhe të kthyerve vështirësohet nga mungesa e bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet hisedarëve komunal, si dhe nga mungesa e bashkërendimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komunës, komunitetit pritës dhe të kthyerve potencial, gjatë përpilimit dhe zbatimit të politikave dhe projekteve.

Sfidat e tilla mund të keqësohen edhe më tej nga qarkullimi i dobët i informatave ndërmjet nivelit qendror, kryesisht Ministrisë për komunitete dhe kthim, dhe nivelit komunal. Në të kaluarën, komunat vazhdimisht janë ankuar për mungesën e informatave dhe udhëzimeve nga niveli qendror që kanë të bëjnë me procesin e zhvillimit të strategjive komunale për kthim. Ngjashëm, komunat shpeshherë janë të painformuara për programet dhe projektet e menaxhuara nga niveli qendror dhe në disa raste për procedurat për aplikim për fondet që janë në dispozicion në nivel qendror për realizimin e projekteve për kthim dhe stabilizim të komunitetit. Që nga fillimi i vitin 2009, Ministria për Komunitete dhe Kthim i është përgjigjur kësaj sfide duke mbajtur takime të rregullta për shkëmbim të informatave me zyrtarët komunalë për komunitete dhe kthim nga të gjitha komunat, duke i përfshirë këtu takimet teknike, si dhe takimet një herë në tre muaj me zyrtarë komunalë nga rajonet e ndryshme, në mënyrë që të përmirësojë komunikimin dhe bashkërendimin

Mungesa e pjesëmarrjes adekuate dhe funksionalitetit të mekanizmave komunalë për bashkërendim

Mungesa e pjesëmarrjes së akterëve relevantë komunalë, duke përfshirë zyrtarët e lartë komunalë, përfaqësuesit e komuniteteve dhe personave të zhvendosur dhe asociacioneve të tyre në mekanizmat komunalë për koordinim për kthim paraqet një

⁸² Mekanizmat lokalë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve janë: komisioni për komunitetet, zëvendës-kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete, Nënkrjetari i Komunës për komunitete, Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, zyrtari komunal për komunitete dhe zyrtarët komunal për kthim.

sfidë tjetër të rëndësishme për zhvillimin dhe zbatimin efektiv të strategjive projekteve në nivel lokal. Në shumë raste, procesi i zhvillimit të strategjive komunale për kthim është vonuar apo penguar në masë të konsiderueshme me faktin që personat e zhvendosur nuk kanë përfaqësim adekuat apo nuk marrin pjesë rregullisht në takimet e grupeve punuese komunale për kthim apo task force specifike të themeluara për monitorimin e progresit të aktiviteteve të kthimit. Ngjashëm, zyrtarët e lartë shpeshherë nuk përfaqësohen në mënyrë adekuate në këto forume. Shpeshherë grupet punuese komunale apo task forcat për kthime nuk janë të rregullta në takime apo nuk takohen fare. Mekanizmat tjerë për pjesëmarrje të komunitetit në komuna konsultohen rrallëherë për të siguruar që aktivitetet për kthim janë në pajtueshmëri me masat tjera që kanë si cak komunitetet joshumicë. Për më tepër, ekzistojnë disa situata në të cilat komuna nuk e ka plotësuar pozitën e zyrtarit komunal për kthim, ku mbajtësi i pozitës kryen funksionet e më shumë së një pune dhe prandaj është i mbingarkuar, apo ku mbajtësi i pozitës nuk është i përkushtuar sa duhet për rolin e tij/saj. Kjo mungesë e përkushtimit apo interesimit nuk prekë vetëm aktivitetin e informimit dhe kujdesin që ofrohet për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, por manifestohet edhe me politika dhe strategji të hartuara dobët në disa komuna.

Përgjithësisht, procesi i kthimit dhe riintegritit mbetet sfidë madhore për komunat e Kosovës. Situata sociale-ekonomike dhe mungesa e mundësive për punësim të leverdishëm janë shqetësime serioze për shumë të kthyer, posaçërisht për komunitetet serbe, rome, ashkali dhe egjiptiane. Veç kësaj, një shqetësim urgjent është ai qasjes së kufizuar në pronë, procedurave të bllokuara apo të zvarritura të rikthimit të pronës dhe uzurpimi joligjor i pronës, përfshirë tokat private, komerciale dhe bujqësore. Një gjë e tillë pengon të kthyerit dhe paraqet një pengesë serioze për komunat, Agjencinë Kosovare për Prona dhe për gjykatat, gjersa dy të fundit janë përgjegjëse për të marrë vendime për ankesat pronësore, si dhe për policinë, e cila është përgjegjëse për dëbimin e uzurpuesve joligjorë. Për disa komunitete, kryesisht romët, ashkallitë dhe egjiptianët, mungesa e pronës është pengesë serioze për kthimin e tyre. Për ta adresuar këtë shqetësim, komunat duhet të tregojnë gatishmëri për të ndarë tokë komunale për projektet për të kthyerit për këto komunitete. Veç kësaj, ata duhet të sigurojnë se i ofrojnë shërbime bazike komunale për personat e zhvendosur dhe të kthyerit, siç janë qasja në shëndetësi, asistencë sociale dhe arsim.

5. PËRFUNDIME

Komunat e Kosovës janë të domosdoshme për t'i dhënë formë politikave të suksesshme për kthim dhe riintegrim dhe për realizimin e nismave lokale për riintegrim dhe zhvillim të cilat krijojnë kushte të favorshme për kthim dhe stabilizim të komunitetit. Megjithatë, varet shumë nga komuna në komunë se në çfarë niveli janë të angazhuara aktivisht komunat në aktivitetet për kthim dhe riintegrim, dhe se në çfarë shkalle marrin pronësinë e procesit. Përafërsisht gjysma e komunave kanë sajuar strategji specifike për t'i adresuar nevojat e të kthyerve dhe personave të zhvendosur, ndërsa përpjekjet për t'i realizuar veprimet dhe aktivitetet e planifikuara kryesisht kanë qenë efektive kur ato janë përforcuar me përkushtim të mjaftueshëm politik dhe mbështetur me intervenime të pandërprera në bashkëpunim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, UNHCR-në dhe aktorët tjerë ndërkombëtarë. Në komunat ku kjo mbështetje nuk është e disponueshme apo është më e vogël, përpjekjet për të

arritur zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur vazhdojnë të jenë të minuara.

Vështirësitë dhe pengesat kryesore me të cilat përballen komunat gjatë zbatimit të politikave, strategjive dhe projekteve për personat e zhvendosur dhe të kthyerit përfshijnë kufizimet buxhetore, mungesën e vullnetit apo përkushtimit politik nga ana e udhëheqjes komunale, mungesës së kapaciteteve të zyrtarëve përkatës komunalë, si dhe problemet me koordinim dhe ndarje të informatave ndërmjet hisedarëve të përfshirë në nivelin qendror dhe lokal. Veç kësaj, qasja e kufizuar në pronë, bllokimi apo zvarritja e procedurave të rikthimit të pronës, qasja e kufizuar në shërbime publike, mungesa e mundësive ekonomike dhe ndjenja e përgjithshme e pasigurisë nga ana e personave të zhvendosur vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për kthimin e qëndrueshëm që duhet të trajtohet fuqishëm në bashkëpunim me të gjithë hisedarët relevantë.

6. REKOMANDIME

Për Qeverinë e Kosovës

- Të kryejë aktivitete të informimit dhe të ngritjes së vetëdijes që kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e komuniteteve joshumicë, përfshirë të drejtën në kthim, si dhe të ofrojë mbështetje në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe aktiviteteve informuese në të gjitha komunat;
- Të sigurojë bashkëpunim dhe koordinim efektiv ndërmjet ministrive përkatëse që janë përgjegjëse për shëndetësi, arsim, punësim, kujdes social, banim dhe atyre që merren me çështje të komuniteteve dhe kthimit, si dhe ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, duke përfshirë këtu takimet e rregullta, shkëmbimin e informatave dhe vlerësimin/raportimin e përbashkët;
- Të ofrojë udhëzime dhe këshilla domethënëse për komunat në lidhje me zhvillimin e politikave, strategjive dhe projekteve për kthim, si dhe të sigurojë komunikim efektiv ndërmjet strukturave qendrore dhe komunale për t'ua mundësuar të gjithë akterëve që të kontribuojnë në proces;
- Të lehtësojë shkëmbimin e informatave dhe praktikave më të mira që kanë të bëjnë me kthimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit në komuna, dhe t'i ndërtojë kapacitetet e institucioneve lokale, si dhe t'i ofrojë mbështetje shoqërisë civile për adresimin e nevojave dhe boshllëqeve të identifikuar;
- Të fuqizojë rolin e zyrtarëve komunalë për kthim dhe zyrave komunale për komunitete, si dhe të sigurojë mbështetje të duhur administrative dhe financiare për t'i mundësuar ata që t'i kryejnë funksionet e tyre në mënyrë efektive;
- T'u sigurojë komunave financim të duhur për realizim efektiv të politikave, strategjive dhe projekteve ekzistuese, si dhe projekteve që kanë për synim t'i ndihmojnë personat e zhvendosur dhe të kthyerit.

Për komunat

- Të kenë aktivitete efektive të informimit drejt personave të zhvendosur, përfshirë edhe përmes vizitave shko-dhe-shih dhe shko-dhe-informohu, si dhe të lehtësohet kontakti, dialogu dhe ndarja e informatave ndërmjet komunës, komunitetit pritës dhe personat e zhvendosur/të kthyerit;

- Të sigurohet pjesëmarrja aktive e zyrtarëve të lartë komunalë, mekanizmave për pjesëmarrje të komuniteteve, shoqërisë civile, komunitetit pritës dhe, veçanërisht, personave të zhvendosur/të kthyerit dhe shoqatat e tyre, në të gjitha fazat e planifikimit dhe realizimit të politikave, strategjive dhe politikave komunale për personat e zhvendosur dhe të kthyerit;
- Të sigurohet se qasja e komunës ndaj kthimit dhe riintegritit është konsistente dhe është pjesë e qasjes së përgjithshme drejt integritit dhe stabilizimit të komuniteteve dhe zhvillimit të komunitetit në përgjithësi;
- Të inkurajohet këmbimi i informatave dhe praktikat më të mira në lidhje me kthimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të komunitetit në komuna;
- Të ndahen resurse adekuate komunale për realizimin e strategjive dhe programeve për t'i mbështetur kthimet apo zgjidhjet tjera të qëndrueshme për personat e zhvendosur/të kthyerit;
- Të sigurohet mbështetja financiare, administrative dhe politike për zyrat komunale për komunitete dhe zyrtarët komunalë për kthim për të fuqizuar rolin e tyre dhe për t'i mundësuar ata që në mënyrë efektive të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë ditore;
- Të promovojnë dhe lehtësojnë kthimin e sigurt dhe të dinjitetshëm të personave të zhvendosur, përfshirë ndarjen e tokës komunale për 99 vite për projektet e kthimit, me qëllim të garantimit të qëndrueshmërisë së procesit të kthimit;
- Të përgatiten dhe realizohen planet për t'i ndihmuar personat e zhvendosur që dëshirojnë të integrohen në nivel lokal.

Për bashkësinë ndërkombëtare

- Të vazhdojnë të ofrojnë mbështetje financiare për nismat për kthim dhe riintegrim, dhe të promovojnë pronësinë qeveritare në nivel të kryeministrisë dhe kryetarëve të komunave, si dhe zhvillimin e kapaciteteve, veçanërisht atyre të nivelit lokal, në realizimin e aktiviteteve të kthimit;
- Gjatë planifikimit dhe realizimit të projekteve të kthimit, prioriteti të vendoset në integrimin social dhe ekonomik të personave të zhvendosur dhe të kthyerve.

Shtojca I: Hartimi dhe miratimi i strategjive komunale për kthim (SKK)

	Komuna	2008 SKK	2009 SKK	2010 SKK
Gjilan/Gnjilane	Ferizaj/Uroševac	✓	✓	-
	Gjilan/Gnjilane	✓	✓	-
	Hani i Elezit/Đeneral Janković*	n/a	-	-
	Kaçanik/Kaçanik	-	-	-
	Kamenicë/Kamenica	✓	✓	-
	Novo Brdo/Novobërdë	✓	✓	✓ (08/05/2010)
	Štrpce/Shtërpçë	-	-	-
	Viti/Vitina	✓	✓	-
Mitrovicë/Mitrovica	Leposavić/Leposaviq	-	-	-
	Mitrovicë/Mitrovica	-	-	-
	Skenderaj/Srbica	✓	✓	-
	Vushtrri/Vučitrn	✓	✓	✓ (04/03/2010)
	Zubin Potok	-	-	-
	Zvečan/Zveçan	-	-	-
Pejë/Peć	Deçan/Deçane	-	-	-
	Gjakovë/Đakovica	✓	-	-
	Istog/Istok	✓	✓	-
	Junik*	n/a	-	-
	Klinë/Klina	✓	✓	-
	Pejë/Peć	✓	✓	-
Prishtinë/Priština	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	✓	✓	✓ (12/07/2010)
	Gllgoc/Glogovac	-	-	-
	Lipjan/Lipljan	✓	✓	✓ (25/05/2010)
	Obiliq/Obilić	✓	✓	-
	Podujevë/Podujevo	✓	✓	✓ (28/04/2010)
	Prishtinë/Priština	✓	-	✓ (08/07/2010)
	Shtime/Štimlje	✓	-	✓ (24/06/2010)
Prizren	Dragash/Dragaš	✓	✓	✓ (22/04/2010)
	Malishevë/Mališevo	✓	✓	-
	Mamuša/Mamushë/Mamuša*	n/a	-	-
	Prizren	✓	✓	-
	Rahovec/Orahovac	-	✓	-
	Suharekë/Suva Reka	✓	✓	✓ (14/05/2010)

* Pilot-njësitë komunale (PNJK) deri në gusht të vitit 2008